



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIC OF KOSOVO  
REPUBLIKA KOSOVA



KOMUNA E PEJËS MUNICIPALITY OF PEJA OPŠTINA PEĆ

---

## DËGJIMET BUXHETORE PËR PROJEKT - BUXHETIN E KOMUNËS SË PEJËS PËR VITIN 2025

**Procesverbalı – Dëgjimi buxhetor me banorët e fshatrave Dobërdol, Llozhan, Graboc, Poçestë, Millovanc, Pishtan, Loxhë, Zllapek, Raushiq dhe Lubeniq.**

Komuna e Pejës - Zyra e Kryetarit

Shkolla fillore në Raushiq

Takimi ka filluar në ora: 18:00

Datë: 06.08.2024

Në shkollën fillore, në fshatin Raushiq, në ora 18:00 është mbajtur dëgjimi publik me banorët e fshatrave Dobërdol, Llozhan, Graboc, Poçestë, Millovanc, Pishtan, Loxhë, Zllapek, Raushiq dhe Lubeniq.

Këto dëgjime publike janë organizuar nga Kryetari i Komunës së Pejës në bashkëpunim me Drejtorinë për Buxhet dhe Financa, si dhe Zyrën për Informim Publik.

Qëllimi i këtyre dëgjimeve është të merren të gjitha kërkesat e qytetarëve nga secili përfaqësues, pastaj t'i nxjerrin prioritetet në bazë të kapaciteteve buxhetore për hartimin e buxhetit të Komunës për vitin 2025.

Në këtë takim kanë qenë të pranishëm Nënkyetari i Komunës së Pejës, z.Fatmir Asllani, Drejtoresha për Buxhet dhe Financa në Komunën e Pejës, znj.Diellëza Berisha, Drejtori për Bujqësi në Komunën e Pejës, z.Tahir Shala, të cilët po tregojnë transparencë ndaj qytetarëve dhe kërkesave të tyre.

Takimin e hapi Drejtoresha Berisha, e cila e kaloj fjalën te Zyrtarja Kryesore Financiare në Komunën e Pejës, znj.Hajrije Haxhijaj, e cila i dha referencat kryesore të projektit të buxhetit dhe pastaj ka hapësirë, që secili nga Ju t'i parashtrojë kërkesat e veta.

Zyrtarja Kryesore Financiare në Komunën e Pejës, znj.Hajrije Haxhijaj i përshëndeti të pranishmit dhe theksoi s'e ndarja e buxhetit bëhet në bazë të Ligjit mbi Menaxhimin e Financave Publike, ku 10 përqind të të hyrave totale të Kosovës ndahen nëpër Komuna dhe pjesa tjeter mbulohet edhe prej të hyrave vetanake, pra buxheti i ndarë për vitin 2025 është 39,689,882, pra është kjo shuma totale e buxhetit, e cila është e ndarë në pesë kategori:

Paga dhe meditje: 18,569,164.75.

Mallra dhe shërbime: 5,297,000.00.

Subvencionet: 1,200,000.00.

Investimet kapitale: 13,618,717.25.

Shpenzimet komunale: 1,005,000.00.

Duhet të theksojmë s'e mund të ketë lëvizje në këto kategori ekonomike për arsyen e neve ende nuk na ka ardhë Qarkorja e Dytë Buxhetore, që ndahet edhe prej Kuvendeve Komunale. Subvencionet janë kategori, të cilat shërbejnë për ndihmë të OJQ-ve, të cilat japid shërbime sociale, për përkrahjen e fermerëve, për përkrahjen e klubeve sportive, aktivitetave rimore, të cilat organizohen në Komunën e Pejës, ndërsa investimet kapitale janë kategori, që shpenzohen në rregullimin e infrastrukturës rrugore, që përfshinë rrugët, ndërtimin e objekteve shkolllore, objekteve shëndetësore, rregullimin e sitemeve të ujites nëpër sipërfaqet bujqësore, projekteve të tjera me donatorë të ndryshëm etj. Te kategoria e subvacioneve, prej vitit 2024 kemi një rritje, prej 120 mijë euro, rritja totale e subvacioneve në buxhet është 11.1% aq sa neve na është leju në bazë të Kornizës Afatmesme Buxhetore.

Tani radha është të kemi diskutim nga ana e juaj fillimisht prezantoheni dhe e hapim diskutimin.

**1.Gentiana Fetahaj** – përshëndetje për të gjithë unë jam nga fshati Raushiq dhe i kam disa kërkesa, siç janë: ndërtimi i një çerdhe në fshatin Raushiq, kanalizimin dhe asfaltimin diku 500 metra, ujësjellësin në fshatin tonë dhe në Bellopojë 500 + 500, trotuari 2 km, ndriçimi 120 trupa, si dhe kanale të ujites 600 metra.

**2.Arif Gjelaj** – përshëndetje unë jam nga fshati Raushiq kemi nevojë për kanalizim të ri në fshatin Raushiq, ndërsa për ndriçim është me defekte, po ashtu dua të më informoni për tabelat e emertimeve të rrugëve.

**3.Nezir Jahmurataj** – përshëndetje jam nga fshati Lubeniq kemi nevojë për një rrrethrrrotullim, rruga Kastrat – Morinë, kanalizimi në Lubeniq, pastaj rryma është shumë e dobët, kemi nevojë për trotuar 1.2 km, rrugën e bjeshkës së Strellcit, shtëpinë e fshatit, asfaltimin në Zagerm 1.2 km, si dhe në lagjen "Isuf Mahmutaj", po e kërkojnë asfaltimin e një rruge.

**4.Taulant Kastrati** nga fshati Graboc kemi nevojë për rregullimin e trotuarit Loxhë – Graboc, kanale të ujitjes, kodin e bizneseve, kemi nevojë për asfaltim, kanalizimi në Graboc të Epërm të lidhet me Loxhë.

**5.Bexhet Alimehaj** nga fshati Lubeniq kemi nevojë për ndriçim publik në lagjen "Alimehaj – Bushat", kanale të shiut, si dhe ujësjellësin.

**6.Fisnik Shala** nga fshati Loxhë kemi nevojë për asfaltimin e rrugës, prej shkollës "2 Korriku" – Market "G – Arbër", me gjatësi 1500 metra, asfaltimi i rrugës nga xhamia deri te përmendorja e Tahir Shalës, me gjatësi 650 metra, asfaltimi i rrugës "Valon Shala" te bistrica, me gjatësi 1000 metra, asfaltimi i rrugës nga xhamia deri te Ademajt, me gjatësi 500 metra, ndërtimi i kanaleve të ujitjes, me gjatësi deri në 2500 metra, ndërtimi i shtëpisë së fshatit në Loxhë, zgjerimi i rrjetit të kanalizimit në rrugën "Ara e madhe", me gjatësi 400 metra, si dhe vendosjen e 40 shtyllave ndriçuese.

**7.Azem Haxhijaj** nga fshati Raushiq ka kërkuar rregullimin e ujësjellësit.

**8.Egzon Kastrati** nga fshati Dobërdol ka kërkuar ndriçimin në fshat, rrugën 600 metra në fshat, shkalla Riza 650, si dhe penden me 200 metra kanal.

Nënkyetari i Komunës së Pejës, z.Fatmir Asllani i përshëndeti të gjithë të pranishmit dhe Ju kthej përgjigje të gjithëve me rend për të gjitha çështjet, të cilat ju interesojnë dhe për të gjitha kërkesat e tyre.

Nënkyetari Asllani takimin e mbylli në ora 19:40.

Procesmbajtësi: Ariana Lukaj



Nr.	EMRI DHE MBIEMRI	VENDBANIMI/ORGANIZATA	GJINIA	NËNSHKRIMI
-----	------------------	-----------------------	--------	------------



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIC OF KOSOVO  
REPUBLIKA KOSOVA



KOMUNA E PEJËS / MUNICIPALITY OF PEJA / OPŠTINA PEĆ

**LISTA E NËNSHKRIMEVE NË TAKIMIN E DEGJIMEVE BUXHETORE PER  
PROJEKT-BUXHETIN VITIN 2025 ME :**

**DOBERDOL,LLOZHAN,  
GRABOC,POQESTE,MILLOVANC,PISHTAN,LOXHE,ZLLAPEK,RAUSHIQ,LYBENIQ**

Vendi:SHKOLLA FILLORE RAUSHIQ

Data:06.08.2024

Ora:18:00

Nr.	EMRI DHE MBIEMRI	VENDBANIMI/ORGANIZATA	GJINIA	NËNSHKRIMI
1	Fision Shelen	LOXHE	M	Don
2	Gentiana Tetahaj	Raushiq	F	Gelataj
3	Osmen Mulliqi	Raushiq	M	Omulliqi
4	Bexhet Alaudaj	Lybeniq	M	Bexhet
5	Ahamet Shabaniq	Lybeniq	M	Ahamet
6	Muzi i Hoxha	Buxheti	M	Muzi
7	Nesir Zekrneci	Buxheti	M	Zekrneci
8	Ergon Kastoli	DOBREDOL	M	Kastoli
9	Fatima Tugan	Pejë DBR	M	Fatima
10	JETON DIPAJI	RAUSHIQ	M	Jetim
11	ZABINOR DINAI RAUSHIQ	RAUSHIQ	M	Zabinoj
12	NISRET ADEMIAJ	RAUSHIQ	M	Nisret
13	ARIF GJELAJ	RAUSHIQ	M	Arif
14	ISMET Bajola	Povestiq	M	Tajnija
15	JAYLAJIT UKASZECI	GRABOC-KOSOVA-NOC	M	Jaylajit
16	OBESI Hoxhaj	Raushiqa	M	Obesi



Nr.	EMRI DHE MBIEMRI	VENDBANIMI/ORGANIZATA	GJINIA	NËNSHKRIMI
-----	------------------	-----------------------	--------	------------

17	Jetënjet Petašiq	RUSHIGË	M	
18	Diellira Beulha	"Peje"	F	Abdullah
19				
20				
21				
22				
23				
24				
25				
26				
27				
28				
29				
30				
31				
32				
33				
34				
35				
36				
37				
38				
39				
40				
41				
42				
43				
44				
45				
46				
47				





REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIC OF KOSOVO  
REPUBLIKA KOSOVA



KOMUNA E PEJËS MUNICIPALITY OF PEJA OPŠTINA PEĆ

---

**DËGJIMET BUXHETORE PËR PROJEKT - BUXHETIN E KOMUNËS SË PEJËS PËR VITIN 2025**

**Procesverbali – Dëgjimi buxhetor me banorët e fshatit Gorazhdec.**

Komuna e Pejës - Zyra e Kryetarit

Qendra Rinore në Gorazhdec.

Takimi ka filluar në ora: 17:00

Datë: 07.08.2024

Në Qendrën Rinore, në fshatin Gorazhdec, në ora 17:00 është mbajtur dëgjimi publik me banorët e fshatit Gorazhdec.

Këto dëgjime publike janë organizuar nga Kryetari i Komunës së Pejës në bashkëpunim me Drejtorinë për Buxhet dhe Financa, si dhe Zyrën për Informim Publik.

Qëllimi i këtyre dëgjimeve është të merren të gjitha kërkesat e qytetarëve nga secili përfaqësues, pastaj t'i nxjerrin prioritetet në bazë të kapaciteteve buxhetore për hartimin e buxhetit të Komunës për vitin 2025.

Në këtë takim kanë qenë të pranishëm Kryetari i Komunës së Pejës, z.Gazmend Muhaxheri dhe Nënkyetari për Komunitete në Komunën e Pejës, z.Mirzet Džogović, të cilët po tregojnë transparencë ndaj qytetarëve dhe kërkesave të tyre.

Takimin e hapi Nënkyetari për Komunitete në Komunën e Pejës, z.Mirzet Džogović, i cili e kaloi fjalën te Zyrtari certifikues në Komunën e Pejës, z.Fatmir Imami, i cila i dha disa nga referencat kryesore të projektit të buxhetit dhe pastaj ka hapësirë, që secili nga Ju t'i parashtroni kërkesat e juaja.

Zyrtari certifikues në Komunën e Pejës, z.Fatmir Imami i përshëndeti të pranishmit dhe theksoi s'e ndarja e buxhetit bëhet në bazë të Ligjit mbi Menaxhimin e Financave Publike, ku 10 përqind të të hyrave totale të Kosovës ndahen nëpër Komuna dhe pjesa tjetër mbulohet edhe prej të hyrave vetanake, pra buxheti i ndarë për vitin 2025 është 39,689,882, pra është kjo shuma totale e buxhetit, e cila është e ndarë në pesë kategori:

Paga dhe meditje: 18,569,164.75.

Mallra dhe shërbime: 5,297,000.00.

Subvencionet: 1,200,000.00.

Investimet kapitale: 13,618,717.25.

Shpenzimet komunale: 1,005,000.00.

Duhet të theksojmë s'e mund të ketë lëvizje në këto kategori ekonomike për arsyet s'e neve ende nuk na ka ardhë Qarkorja e Dytë Buxhetore, që ndahet edhe prej Kuvendeve Komunale. Subvencionet janë kategori, të cilat shërbejnë për ndihmë të OJQ-ve, të cilat japid shërbime sociale, për përkrahjen e fermerëve, për përkrahjen e klubeve sportive, aktivitetet rinore, të cilat organizohen në Komunën e Pejës, ndërsa investimet kapitale janë kategori, që shpenzohen në rregullimin e infrastrukturës rrugore, që përfshinë rrugët, ndërtimin e objekteve shkolllore, objekteve shëndetësore, rregullimin e sitemeve të ujites nëpër sipërfaqet bujqësore, projekteve të tjera me donatorë të ndryshëm etj.

Te kategoria e subvacioneve, prej vitit 2024 kemi një rritje, prej 120 mijë euro, rritja totale e subvacioneve në buxhet është 11.1% aq sa neve na është leju në bazë të Kornizës Afatmesme Buxhetore.

Tani radha është të kemi diskutim nga ana e juaj fillimisht prezantoheni dhe e hapim diskutimin.

**1.Miloš Dimitrijević** – përshëndetje për të gjithë në tri vitet e fundit nuk është investu asgjë, projektet e vittit 2024 nuk kanë fillu investimet, as subvencionet, si dhe kemi dëgju, që është hap një konkurs për vendin e Zyrës për Komunitete në Gorazhdec.

**2.Stevaravić Miroslav** – përshëndetje për të gjithë ne problemet i kena të mëdha, në tri vitet e fundit nuk ka investime, ku është problemi pse nuk ja keni nis asnë projekt, po e kérkoj një kanal, prej 550 metra, çka është bërë për penden, sepse shumë, po ka ujë dhe ujëra të zeza, na nevojitet shumë kanali për krejt Gorazhdecin, kérkesë e jona është rrrethojat për varrezat e fshatit, ndërsa për kérkesën për kanal 1500 metra punimet kanë fillu.

**3.Dašan Portić** – përshëndetje për të gjithë ne kemi kérkesa për trotuar në fshat, sepse po

ka shumë fëmijë, kanë fillu punimet dhe ashtu kanë mbet.

**4.Luka Zlatićanin** – përshëndetje për të gjithë ne kemi nevojë shumë për policë të shtrirë, sepse po lëvizin shumë automjetet.

**5.Bregovi Stevanović** – përshëndetje për të gjithë ne kemi nevojë për një kanal rrëth 550 metra.

**6.Milan Andjelović** – përshëndetje për të gjithë kemi nevojë për fillimin e arsimit në shkollën fillore, kërkesa për policë të shtrirë afér shkollës edhe sinjalizimi, kemi probleme me ambient, sepse nuk po vijnë me i marr mbeturinat.

Kryetari i Komunës së Pejës, z.Gazmend Muhaxheri, Ju kthej përgjigje të gjithëve me rend për të gjitha çështjet, të cilat atyre ju interesuan dhe për të gjitha kërkesat e tyre.

Nënkyetari Džogović takimin e mbylli në ora 17:50.


Procesmbajtësi: Ariana Lukaj



Br.	Ime i Prezime	Boravak/Organizacija	Pol	Potpis
-----	---------------	----------------------	-----	--------



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIC OF KOSOVO  
REPUBLIKA KOSOVA



KOMUNA E PEJËS / MUNICIPALITY OF PEJA / OPŠTINA PEĆ

**LISTA E NËNSHKRIMEVE NË TAKIMIN E DEGJIMEVE BUXHETORE PER  
PROJEKT-BUXHETIN VITIN 2025 ME :**

*Lista Potpisa na Sastanku budžetskih saslušanja za projekat budžeta - 2025 god.*

*Gorazhdevac*

*Mesto: Omladinski Centar Goraždevac*

*Datum: 07.08.2024*

*Vreme : 17:00*

Br.	Ime i Prezime	Boravak/Organizacija	Pol	Potpis
1	ZLATKO, Petrić	GORAŽDEVAC	M	ZD
2	PETROVIĆ VLASIO	GORAŽDEVAC	M	P. Š.
3	LILIA ZLATIĆANIN	GORAŽDEVAC	M	Lilja. Ž
4	MILOR ĐIMITRIJEVIĆ	GORAŽDEVAC	M	Milor. Đ
5	ĐEVAK HAJRËT JUBORIĆ		M.	Đevar. Hajrët
6	Čopov Jelena	Jelena Čopov	M.	Čopov
7	Rajka Iva	-/-	M	Rajka
8	M. Zlatanović	-/-	M	M. Zlatanović
9	MILOVAN ĐIMITRIJEVIĆ	-/-	M	Milovan Đ.
10	POPIĆ ĐOJAN	GORAŽDEVAC	M	D. Popić
11	Đurić Milivoj	-/-	M	Đurić
12	Uzbešan, Bush	-/-	M	Uzbešan, Bush
13	Antonija Žguderlet	TOPAHLJEVAC	M	A. Žguderlet
14				



Br.	Ime i Prezime	Boravak/Organizacija	Pol	Potpis
-----	---------------	----------------------	-----	--------

15	Krunoslav Bogolovac	GORAZDEVAC	M	(P)
16	Milovan Djurkovic	GORAZDEVAC	M	(S)
17				
18				
19				
20				
21				
22				
23				
24				
25				
26				
27				
28				
29				
30				
31				
32				
33				
34				
35				
36				
37				
38				
39				
40				
41				
42				
43				
44				
45				





REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIC OF KOSOVO  
REPUBLIKA KOSOVA



KOMUNA E PEJËS MUNICIPALITY OF PEJA OPŠTINA PEĆ

---

**DËGJIMET BUXHETORE PËR PROJEKT - BUXHETIN E KOMUNËS SË PEJËS PËR VITIN 2025**

**Procesverbalı – Dëgjimi buxhetor me banorët e fshatrave të Lugut të Baranit.**

Komuna e Pejës - Zyra e Kryetarit

Shkolla fillore në Baran

Takimi ka filluar në ora: 18:00

Datë: 07.08.2024

Në shkollën fillore, në fshatin Baran, në ora 18:00 është mbajtur dëgjimi publik me banorët e fshatrave të Lugut të Baranit.

Këto dëgjime publike janë organizuar nga Kryetari i Komunës së Pejës në bashkëpunim me Drejtorinë për Buxhet dhe Financa, si dhe Zyrën për Informim Publik.

Qëllimi i këtyre dëgjimeve është të merren të gjitha kërkesat e qytetarëve nga secili përfaqësues, pastaj t'i nxjerrin prioritetet në bazë të kapaciteteve buxhetore për hartimin e buxhetit të Komunës për vitin 2025.

Në këtë takim kanë qenë të pranishëm Drejtoresha për Buxhet dhe Financa në Komunën e Pejës, znj.Diellëza Berisha dhe Drejtori për Bujqësi në Komunën e Pejës, z.Tahir Shala, të cilët po tregojnë transparencë ndaj qytetarëve dhe kërkesave të tyre.

Takimin e hapi Drejtoresha Berisha, e cila e kaloi fjalën te Zyrtarja Kryesore Financiare në Komunën e Pejës, znj.Hajrije Haxhijaj, e cila i dha referencat kryesore të projektit të buxhetit dhe pastaj ka hapësirë, që secili nga Ju t'i parashtrojë kërkesat e veta.

Zyrtarja Kryesore Financiare në Komunën e Pejës, znj.Hajrije Haxhijaj i përshëndeti të pranishmit dhe theksoi s'e ndarja e buxhetit bëhet në bazë të Ligjit mbi Menaxhimin e Financave Publike, ku 10 përqind të të hyrave totale të Kosovës ndahen nëpër Komuna dhe pjesa tjetër mbulohet edhe prej të hyrave vetanake, pra buxheti i ndarë për vitin 2025 është 39,689,882, pra është kjo shuma totale e buxhetit, e cila është e ndarë në pesë kategori:

Paga dhe meditje: 18,569,164.75.

Mallra dhe shërbime: 5,297,000.00.

Subvencionet: 1,200,000.00.

Investimet kapitale: 13,618,717.25.

Shpenzimet komunale: 1,005,000.00.

Duhet të theksojmë s'e mund të ketë lëvizje në këto kategori ekonomike për arsyet s'e neve ende nuk na ka ardhë Qarkorja e Dytë Buxhetore, që ndahet edhe prej Kuvendeve Komunale. Subvencionet janë kategori, të cilat shërbijnë për ndihmë të OJQ-ve, të cilat janë shërbime sociale, për përkrahjen e fermerëve, për përkrahjen e klubeve sportive, aktivitetet e rinore, të cilat organizohen në Komunën e Pejës, ndërsa investimet kapitale janë kategori, që shpenzohen në rregullimin e infrastrukturës rrugore, që përfshinë rrugët, ndërtimin e objekteve shkollore, objekteve shëndetësore, rregullimin e sitemeve të ujites nëpër sipërfaqet bujqësore, projekteve të tjera me donatorë të ndryshëm etj.

Te kategoria e subvencioneve, prej vitit 2024 kemi një rritje, prej 120 mijë euro, rritja totale e subvencioneve në buxhet është 11.1% aq sa neve na është leju në bazë të Kornizës Afatmesme Buxhetore.

Tani radha është të kemi diskutim nga ana e juaj fillimisht prezantoheni dhe e hapim diskutimin.

**1. Sali Krasniqi** – përshëndetje për të gjithë jam nga Barani, që 15 vjet nuk kam parë ekip më të mirë, por investimet fatkeqësish, po shkojnë drejt politikës. Ne e dime në Baran qysh janë shku e qysh, po shkojnë, mu personalisht më është dasht me kërkua, prej Nezir Berishës për me shtru do asfalt për arsyet e çështjeve politike. Janë disa vite dhe nuk e besoj, që ndonjëri nga Ju ka qenë, atëherë kam kërkua për një ndriçim, janë disa vite, që kam kërkua kanalin e ujites janë 300 metra, që me na dërgu deri në fund të udhës për me shku, është ndal kanali i ujites te shkolla, për mos me ardhë te poshte, janë disa vjet, që kam kërkua, që kanali nëpër oborr të shkollës me u hap për arsyet s'e disa kusherinj të mi sot kanë pas probleme u janë prish 2 hektarë lakna për shkak të kësaj vije, që nuk ka qenë e hapur ka disa vjet, që kam kërkua për ujë, i cili po shkon nëpër livadhe të buta, që i thojmë na, është bërë një kanal i mirë, por të gjitha shkarkimet e atyre ujërave janë bërë në livadh timin, pra ai, që e ka projektu është dasht me ditë qysh me projektu, ndriçimi, kanali i ujites, kanali i

kullosave, që kanë premtu, që do t'i hapin, por i kanë mbyll, trotuari, që është afër këtu beso, që nuk ecët nëpër të, ka erdha deri këtu erdha nëpër asfalt, sepse nuk pata mundësi me ec nëpër trotuar aq shumë, po rriten labodat, nëpër oborr të shkollës edhe drejtori është këtu e keni pa edhe vetë në çfarë gjendje është, pra është një gjendje e mjerueshme asgjë nuk është sot çka ka qenë gjatë punimeve, që kanë punu fusha çdo fëmijë, i cili është end aty pari ka mujt me mbyt krejt, kemi edhe kemi pas shumë kërkesa, sidomos unë vetë me Drejtorin e Bujqësisë, z.Tahir Shala e kemi bërë një kanal të ujitjes për fshatin e Çallapekut, nëpër secilin livadh ose nëpër secilën pronë janë kanë ka dy ose tri presa, por vetëm një presë është bërë për ndalesen e ujit, është bërë, ndërsa të gjitha të tjerat janë pandalesë, prapë duhet me i nxan me baltë. Të gjitha këto, që po i flas mund t'i shihni për 30 minuta, po i shoh sot disa investime, që janë duke u bërë në biznese, është shumë mirë me ju ndihmu bizneseve për asfalt e kemi Musa Krasniqin, i cili e ka një biznes në Baran më i madhi dhe që ka kontribu më së shumti për tatime. Sot, po investohet në ato biznese, që as nuk paguajnë tatime çka bëhet është mirë, por mos t'i dërgojmë këto investime në drejtim të gabuar, mos t'i qojmë në investime në humbje, sepse çka po bëhet, po bëhet keq, pra çka po bëhet, po bëhet veç sa mu pa, rrugë e asfalta, besoj, që të gjitha këto çka i fola tash, çka kam kërku para disa viteve janë të gjitha të regjistruara para disa viteve nuk e di a janë vendos të gjitha në procesverbal, por ka qenë inçizimi aty edhe sot janë të njëjtat dhe janë shumë më keq sesa kanë qenë. Ata, që janë nëpër këto rajone për të cilat fola unë e dinë qysh është situata, nuk po flas për fshatra tjera, por për Baran kjo është situata. Ju faleminderit!

**2.Naim Krasniqi** – ju përshëndes të gjithëve, sot po flas në emër të drejtorit të shkollës për dy gjëra, të cilat u ceken në shkollë kanali nuk është i mbyllur, sa i përket oborrit të shkollës shumica e dinë, që i kanë nxënësit këtu, kolegët e mi e dinë s'e këtu asnjë makinë nuk futet në oborr të shkollës, por na është dasht me leju për makinat, të cilat e punojnë fushën sepse është e vëtmja rrugë këtu, oborri i shkollës është shumë i sigurt ndër më të sigurtit për nxënës, vetëm nëse kemi për të bartë material, për oborr e për gjendje normal, po shihet, që shkolla nuk është mirë, janë bërë edhe disa punime të tjera edhe duhet pak kohë, që me i rregullu ato pjesë, që janë të prishura. Ju faleminderit shumë për kohën, që na e dhatë, ndërsa kërkesat tona do t'i drejtojmë në Drejtorinë e Arsimit.

**3.Atdhe Berisha** – përshëndetje për të gjithë jam nga Çallapeku ajo, që ka qenë projekt në vitin e kaluar dhe kemi bisedu ka me fillu së shpejti dhe disa prej projekteve veç sa janë realizu kanali i ujitjes në gjatësi 2100 metra veçse është përfundu, ne si fshat jemi të organizuar mirë dhe i kemi përfundu disa projekte, renovimi dhe ndërtimi i shtëpisë së fshatit nuk ka qenë kërkesë për komunën, sepse ne e kemi kry vetë, kosto e së cilës ka qenë mbi 40 mijë euro e kemi mbulu me vetëfinancim dhe jemi të kënaqur, ne kemi nevojë për zgjerimin e ndriçimit në fshatin tonë dhe në lagjen "Kamenica", ndërtimi i dy pendave për ujitje, tri urave dhe tri pendave të tjera, ndërtimin e së paku 3000 metrave kanale të ujitjes, të cilat e përmbyllin gati fshatin tonë edhe hapjen e shtretërve të lumenjve, sepse është problem për disa fshatra, problem është te përmbytjet, të cilat po ndodhin, kemi probleme me kanalizim, kemi problem me ujë të pijes, i cili është një problem madhor, ndërtimi i një ure në rrugën te varrezat, në lagjen "Kamenica" është problem për me u ngjit deri te

varrezat, rruga, që të dërgon deri te varrezat ka nevojë me pas një kanal kullues e sidomos kur bjen shi është tepër problem, ndërsa Drejtorin për Bujqësi në Komunën e Pejës, z.Tahir Shala deshta me e falënderu, që i ka ndihmuar fermerët tanë për mekanizëm bujqësor dhe na bën me u ndi mirë, por kërkojmë, që kjo mbeshtetje të vazhdojë tutje, që të kalojmë në një stad tjetër të punimit të tokave edhe e fundit para s'e të vijë këtu në takim patëm një vatër të zjarrit, zjarrfikësit i kemi në Pejë dhe deri të vijnë a mos kish qenë ide e mirë për me e pas çdo Bashkësi Lokale nga një njësi s'po e them, por me e pas nga një vullnetar, sepse unë e kam përfundu një trajnim, i cili ka zgjatë katër vjet dhe jam i certifikuar për fatkeqësi dhe zjarre vullnetarisht trajnimet mundem me jau mbajt unë, ndërsa ju na i paguani mjetet për shuarje të zjarrit dhe vazhdojmë tutje, sepse kemi pas shumë probleme për me e shu zjarrin.Ju faleminderit shumë dhe besoj, që kërkesat tona do të realizohen.

**4.Demë Gashi** – Jam Kryetar i fshatit Baran sa i përket punëve edhe kërkesave, të cilat i kemi bërë shumica e kërkesave janë përfundu, po flas më shumë për fshatin tim, por kemi edhe punë, që s'janë kry i kemi disa rrugë për t'u asfaltu, kemi edhe ndriçimin edhe i kemi varrezat me i rrethu para dy viteve e kemi bërë kërkesën për me i rrethu varrezat, kanal të ujitjes i kemi diku 700 metra në lagje atje, që lidhen, penda është, por kanali i ujitjes nuk është, e kemi një rrugë te kodrat qetu, që i kemi 120 hektar është rruga shumë e keqe, edhe një ndriçim të rrugës, prej shkollës këtu e deri te shtëpia e fundit e fshatit Baran janë diku 300 metra, ka punu mjaft, kanalet kryesore janë bo, trotuari veç ka hy në tender Baran – Kotradiq, ndërsa shumë fjalë, të cilat i folën parafolësat nuk janë të vërteta janë dallavere, rrena, por njeriu duhet ta flasë realitetin s'e çka është bërë, sepse në Baran e dimë, që Komuna kanë punu shumë mirë dhe i ka realizu kërkesat.

5.Sali Krasniqi dua ta marr fjalën edhe njëherë unë ju kisha propozu për të gjitha këto çka i fola unë ju ftoj të gjithëve, që të shkojmë së bashku t'i shkojmë nga afër, nëse diçka është rren atëherë del rrenci i vërtetë njeriu, i cili po thotë, që po rrej e kam pas kujdestar klase 4 vjet dhe më vjen keq t'i kthehem e t'i them ti po rren, mirëpo do të shkojmë dhe të shohim realitetin. Nuk du me hi hiç në debat, por të shkojmë t'i shkojmë.

**6.Anton Antoni** – Ju përshëndes përzemërsisht, jam nga Gllogjani dhe në emër të qytetarëve dhe në emër të delegatit z.Nezir Berisha, Ju përgëzoj për punët, që po bëhen dhe për kërkesat në bashkëpunim me Kryetarin e Lugut të Baranit unë do t'i paraqesë kërkesat e qytetarëve të mi, që së bashku me delegatin me Kryetarin Rasim Bersisha, Mark Kabashin edhe Deden, po i përgatisim kërkesat dhe neser do t'i keni të gjitha kërkesat në drejtoritë përkatëse, dua ta falënderoj Kryetarin për angazhimin e madh, jo vetëm për qytetarët e Komunës së Pejës, por ju ka dal në ndihmë t'u fitu projekte në bashkëpunim me Ministrinë ka arrit me e realizu një projekt tepër të rëndësishëm, pra ky është falënderim i posaçëm nga ne. Faleminderi shumë për kohën! Po dëgjoj këtu, ju garantoj me përgjegjësi të plotë nuk do të jem Kryetar i Bashkësisë Lokale nëse te ne ka firma të regjistruala dhe që nuk i paguajnë tatimet. Unë jam ai, që kam kërku për varreza, që dy vjet kam kërku personi në fjalë e ka lëshu emër e mbiemër Sadri Berisha me bashkëpunëtorët e mi na e ka lëshu për varreza atë vend, pra në momentin, që ngritet një kritik për qytetarët e mi jam i gatshëm në mënyrë ligjore, që të përgjigjem. Ne do të punojmë me argumente në bazë të Komunës, që

është më e zellshme në nivel Kosove, pra mos t'i fajësojmë të tjerët së pari ta fajësojmë vetveten. Jam i gatshëm t'ju përgjigjem.

**7. Muhamet Berisha** – përshëndetje për të gjithë unë jam nga Kryesheci dhe na i kemi disa projekte jemi duke i kry duke ju falënderu Komunës dhe stafit të saj, po kemi edhe nevoja të tjera, një kanal, që është ndërtu vjet ka mbet edhe për 200 metra, një urë, e cila e lidh fshatin e Kryshecit me fshatin Broliq aty ka nevojë me intervenu s'e vërvshimet, po bëjnë shumë dëme, disa asfalte janë t'u kry, po ka nevojë edhe për disa anekse, unë të gjitha do t'i ceki në kërkesë me shkrim lagje për lagje e në fshatin Rashiq kam kërkesë, prej banorëve diku 700 metra një ndriçim të ri dhe riparimin e ndriçimit, që është dëmtu dhe te Gjocajt 70 metra kanal. Nuk, po marr kohë më shumë. Ju faleminderit shumë!

**8. Haxhi Krasniqi** – përshëndetje për të gjithë unë jam nga Turjaka e kam bërë një kërkesë për trotuarin, prej shkollës deri te stacioni i autobusëve e deri në qendër atje dhe 150 metra trotuar për në shkollë, kërkesa tjetër është në fshatin Vranoc një pend e vogël dhe 150 metra kanal të ujites.

**9. Selman Krasniqi** – përshëndetje për të gjithë unë jam nga Vranoci, pa ardhë kanali deri në Vranoc kemi prit, që 25 vjet këtë vit është bërë.

**10. Driton Gashi** – përshëndetje për të gjithë unë jam nga fshati Buçan i kam katër kërkesa për Drejtorinë për Shërbime Publike dhe Punë Komunale: kanalin e reshjeve atmosferike me gjatësi 784 metra, rrugicat nëpër fshat, prej 600 metrave, rregullimin e parkingut tek varrezat e fshatit Buçan, ndriçimi i fshatit dhe zgjerimi i fshatit, ndërsa kërkesat tjera janë për Drejtorinë për Bujqësi, si kanali i ujites me gjatësi, prej 960 metra, në të cilin ujiten 30 hektarë misër, penda, e cila është në pjesën e dytë të fshatit, prej 60 hektarëve. Ju faleminderit!

**11. Veton Dervishaj** – përshëndetje për të gjithë unë jam nga fshati Kotradiq edhe unë po fokusohna te kanalet e ujites e falënderoj Drejtorin e Bujqësisë, z.Tahir Shala për bashkëpunim dhe po kérkoj me vazhdu me pjesët e tjera, na ujë kemi mjaft është rajon i njohur bujqësor, ndërsa vitin e kaluar e kam pas një kërkesë për ndërtim e urës i kemi afër 60 hektarë tokë, por s'kemi urë për me kalu andej me mekanizëm bujqësor, po ashtu kemi nevojë për kanalizim dhe ujësjellës në këtë rajon, po ecin shumë kadale dhe ndriçimi edhe pse na shumica në fshat i kemi vendos vetë, por ka nevojë me qenë disa drita nëpër disa shtylla.

Drejtori për Bujqësi në Komunën e Pejës, z.Tahir Shala i përshëndeti të gjithë të pranishmit dhe Ju kthej përgjigje të gjithëve me rend për të gjitha çështjet, të cilat ju interesojnë dhe për të gjitha kërkesat e tyre.

Drejtori Shala takimin e mbylli në ora 19:15.

Procesmbajtësi: Ariana Lukaj

Nr

EMRI DHE MBIEMRI


VENDBANIMI/ORGANIZATA

GJINIA

NËNSHKRIMI



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIC OF KOSOVO  
REPUBLIKA KOSOVA



KOMUNA E PEJËS / MUNICIPALITY OF PEJA / OPŠTINA PEĆ

**LISTA E NËNSHKRIMEVE NË TAKIMIN E DEGJIMEVE BUXHETORE PER  
PROJEKT-BUXHETIN VITIN 2025 ME :**

**FSHATRAT E LUGUT TE BARANIT**

Vendi: SHKOLLA FILLORE BARAN

Data: 07.08.2024

Ora: 18:00

Nr.	EMRI DHE MBIEMRI	VENDBANIMI/ORGANIZATA	GJINIA	NËNSHKRIMI
1	Muhamed Berisha B. Z. Kushe		M.	044-713-957
2	Anton Antoni B. Z. Qilogjan		M.	049-112-036
3	MARK KABASHI	GLLOGJAH	M	Kababi
4	Irr Gashi	BUCAN	M	Gashi
5	Vetan Deviqaj	KOHNUK	M	Deviqaj
6	Rifat Krasniqi	KOFOLQI	M	Rifati
7	Nezmon Soldi	KOFOLQI	M	Nezmon
8	SKENDER KRAZNO	VRANOĆ	M	Skender
9	Driton Gasiti	BUCAN	M	Gasiti
10				
11	Zymer	Gdhi		Zymer
12				
13	BESIM	GASHI		Besim
14	Mcder	Berisha		Mcder
15	SHKOLJA	GASHI	M	Shkola
16	RILINDA	BERISHA	M	Rilinda
17				



Nr.	EMRI DHE MBIEMRI	VENDBANIMI/ORGANIZATA	GJINIA	NENSHKRIMI
18	Altise Kohcaj	Barave i ulet	M.	<i>Altise</i>
19	SITCI KRASTNIQI	M	M	<i>SITCI</i>
20	Hoxha Krasniqi	Turjakci	M	<i>Hoxha</i>
21	Syl Gole	Kole	M	<i>Syl</i>
22	dajmij Prezgjed	Vranoc	M	<i>dajmij</i>
23	Afetore Kucihi	Gollajci	M	<i>Afetore</i>
24	Aezib Beqo	Ilogji		<i>Aezib</i>
25	RASIM PERISHA LUGAGJI	LUGAGJI		<i>RASIM</i>
26	FATIMA MAMU DESAN DBC	VRANOC	M	<i>FATIMA</i>
27	SELMON KRASTNIQI	VRANOC	M	<i>SELMON</i>
28	DENE BASHI	BARDH	M.	<i>DENE</i>
29				
30				
31				
32				
33				
34				
35				
36				
37				
38				
39				
40				
41				
42				
43				
44				
45				
46				
47				
48				



Takimin e hapit Nenkrystari Asllani, i cili e kaloj falan te Zyratja Kryesore Financiare ne Komuneen e Pejes, zy.Hajnje Haxhija, e cila i dha disa nga referencat kryesore te

Drejtoresha per Buxheti dhe Financa ne Komuneen e Pejes, z.Tahir Shala, te cilte po tregojne transparence nadaj per Bujdesi ne Komuneen e Pejes, z.Dilekza Berisha dhe Drejtori Drejtoresha per Buxheti dhe Financa ne Komuneen e Pejes, z.Fatmir Asllani, Ne kete takim kane te pranishem Nenkrystari i Komunes se Pejes, z.Fatmir Asllani,

Qeliimi i ketyre degjimeve eshte te merren te gjitha kerkesat e qytetarave nga secelli perfademus, pastaj ti nxjerin prioritetet ne base te kapacitetave buxhetore per hartimin e buxhetit te Komunes per vitin 2025.

Drejtorene per Buxhet dhe Financa, si dhe Zyren per Informim Publik. Keto degjime publike janë organizuar nga Kryetari i Komunes se Pejes ne bashkepunim me

Në shkollën fillore, në fshatin Qyshk, në ora 19:30 eshte mbajtur degjimi publik me banoret e fshatrave te Lugut te Leshanit.

Date: 07.08.2024

Takimi ka filluar ne ora: 19:30

Shkolla fillore ne Qyshk

Komuna e Pejes - Zyra e Kryetarit

Procesverbali - Degjimi buxhetor me banoret e fshatrave te Lugut te Leshanit.



2025  
DEGJIMET BUXHETOKE PER PROJEKT - BUXHETIN E KOMUNES SE PEJES PER VITIN

KOMUNA E PEJES MUNICIPALITY OF PEJA OPSINA PEĆ

REPUBLICA KOSOVA

REPUBLIC OF KOSOVO

REPUBLICA E KOSOVES



juga.

projektit te buxhestit dhe pastaj ka hapseire, qe secli naga ju ti parashtoni kerkesat e

Zyrtarja kryesore Financiare ne Komunen e Pejes, znj. Hajrige Haxhija i pershendet te  
pranishmit dhe theksoi se buxhetit beshet ne bazet te Ligjet mbi Menaxhimini e  
Financave Publike, ku 10 perqind te hyrave totale te Kosoves ndahen neper Komuna dhe  
39,689,882, pra eshte kjo shuma totale e buxhetit, e cila eshte e ndare ne pesë katgori:  
Paga dhe medite: 18,569,164,75.  
Mallra dhe sherbime: 5,297,000.00.  
Subvencionet: 1,200,000.00.  
Investiment Kapitale: 13,618,717,25.  
Shpenzimet komunale: 1,005,000.00.

Duhet te theksojme se mund te kete levizje ne keto katgori ekonomike per arsy se neve  
ende nuk na ka ardhë Qarkoja e Dytë Buxhetore, qe ndahet edhe prej Kuvendave  
komunale. Subvencionet janë katgori, te cilat shërbejnë per ndihme te QJQ-ve, te cilat  
aktivitetave rinore, te cilat organizohen ne Komunen e Pejes, ndërsa investimet kapitale janë  
kategorit, qe shpenzohej ne regjullimin e infrastrukturës rrugore, qe perfsihinë rrugët,  
ndërtimin e objekteve shkollore, objekteve shëndetësore, regjullimi i sitemeve te ujites  
nëpër sipërfaqjet bujqësore, projekteve të tjera me donatorë te ndryshem etj.

Te katgoria e subvencioneve, prej vitit 2024 kemi një rritje, prej 120 mijë euro, rritja totale e  
subvencioneve ne buxhet eshte 11,1% ad sa neve na eshte leju ne bazë te kornizës  
Afatmesme Buxhetore.  
Tani radha eshte te kemi diskutim naga ana e juaj filimisht prezantoheni dhe e hapim  
diskutimin.  
**1.Qaush Bajrushi** – pershendetje per te gjithe ne Leshan kemi nevoje per nevoje  
uji ne Leshan dhe ne Kilgine, pend ne bjeshtet e listogut ne grumbullimin e ujut, 2-3 pend  
te vogla, si dhe problemi me ujaret e zezat.

**2.Istref Atashi** naga Leshan pershendetje per te gjithe ambulanca ne fshatin Leshan, si dhe  
mirembajta e kullese se Haxhi Zekes.

Procesmbajtësi: Ariona Lukaj

Nënkryetari Asllani takimin e mbylli në ora 20:30.

Nënkryetari Asllani, ju kthej përgjigje të gjithëve me rend për të gjitha gëshfjetë, të cilat atyre ju interesuan dhe për të gjitha kërkësat e tyre.

**6. Hasan Shala** një fshati Qyshk, ju përshtendes të gjithëve kemi nevoje për kanalizim në lagjet Gashi dhe Shala, kanali i ujites 1,5 metra, pendë për ujite dhe disa rruge të tjera, pra të gjitha kërkësat do ti adresojmë me shkrim te Drejtortë Përkatese.

**5. Sadiku një fshati Rrosjë** përshtendetje për të gjithë, kemi nevoje për 500-600 metra, sepse kanali, po vërsion, 200 deri në 300 metra rrujica, si dhe ndriçimi.

**4. Hivzi Alija** një fshati Leshanë përshtendetje për të gjithë kemi nevoje për rrjeme, për tri pendë, kanalin e mbyllur, si dhe për kanalat e ujites.

**3. Rame Nimonë** përshtendetje për të gjithë kemi nevoje për ujite, kronti i fshatit, ndriçimi i fshatit, gerdhe, rruga e bështkes dhe rruga e re.



Nr.	EMRI DHE MBIEMRI	VENDBANI/ORGANIZATA	GJINA	NENSHKIMI
1	SELTON SITACU	E. QYSHE	H. Blumi	
2	BALI MEIJA	F. LESHATA	H. Bratofor	
3	GRIBA KERTEVA	F. BOJSUZE	H. Gjelaj	
4	SALI KERTEVA	F. BOJSUZE	H. Gjelaj	
5	SANI CESHIQI	F. BOJSUZE	H. Gjelaj	
6	FATIM KELMENDI	F. QYSHE	M. Dushka	
7	HYZI ALIJA	LESHATA	M. Dushka	
8	RAMA XHAMOVA	GLLOVQE	M. Dushka	
9	ZEKE FERDULI	ZAHATA	M. Dushka	
10	LAZAN SHARIA	F. QYSHE	M. Dushka	
11	TAZET ALIAJU	LESHATA	M. Dushka	
12	CADUSH BAJRUS	~ 2013.9.14	M. Dushka	
13	FATIJA LIPRU	QYSHE	M. Dushka	
14	SHAKA			
15				
16				

Ora: 19:30


Data: 07.08.2024

Vendi: SHKOLLA FILLORE QYSHE

## FOSHATRAT E LUGUT TE LESHANT

LISTA E NENSHKIMEVE NE TAKMINI E DEGJIMEVE BUXHETORE PER  
 PROJEKT-BUXHETIN VITNI 2025 ME:

KOMUNA E PEJES / MUNICIPALITY OF PEJA / OPSTINA PEĆ



REPUBLIKA KOSOVA  
 REPUBLIC OF KOSOVO  
 REPUBLIKA E KOSOVËS



Nr.	EMRI DHE MBIEMRI	VENDBANI/ORGANIZATA	GJINA	NENSHKIMI
-----	------------------	---------------------	-------	-----------





REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIC OF KOSOVO  
REPUBLIKA KOSOVA



KOMUNA E PEJËS MUNICIPALITY OF PEJA OPŠTINA PEĆ

---

**DËGJIMET BUXHETORE PËR PROJEKT - BUXHETIN E KOMUNËS SË PEJËS PËR VITIN 2025**

**Procesverbali – Dëgjimi buxhetor me banorët e fshatrave Trestenik, Nabërgjan, Treboviq, Ruhot, Lutogllavë, Llabjan, Bllagajë dhe Nakull.**

Komuna e Pejës - Zyra e Kryetarit

Shkolla fillore në Nabërgjan

Takimi ka filluar në ora: 20:00

Datë: 02.08.2024

Në shkollën fillore, në fshatin Nabërgjan, në ora 20:00 është mbajtur dëgjimi publik me banorët e fshatrave Trestenik, Nabërgjan, Treboviq, Ruhot, Lutogllavë, Llabjan, Bllagajë dhe Nakull.

Këto dëgjime publike janë organizuar nga Kryetari i Komunës së Pejës në bashkëpunim me Drejtorinë për Buxhet dhe Financa, si dhe Zyrën për Informim Publik.

Qëllimi i këtyre dëgjimeve është të merren të gjitha kërkesat e qytetarëve nga secili përfaqësues, pastaj t'i nxjerrin prioritetet në bazë të kapaciteteve buxhetore për hartimin e buxhetit të Komunës për vitin 2025.

Në këtë takim kanë qenë të pranishëm Kryetari i Komunës së Pejës, z.Gazmend Muhaxheri, Kryesuesi i Kuvendit Komunal të Pejës, z.Rexhep Kurtbogaj, Drejtoresha për Buxhet dhe Financa në Komunën e Pejës, znj.Diellëza Berisha, Drejtorë të ekzekutivit, të cilët po tregojnë transparencë ndaj qytetarëve dhe kërkesave të tyre.

Takimin e hapi Kryesuesi i Kuvendit Komunal të Pejës, z.Rexhep Kurtbogaj, i cili i përshëndeti të pranishmit dhe Ju uroj mirëseardhje në dëgjimin publik për projektimin e buxhetit për vitin e ardhshëm. Thirrja për këtë takim ka qenë, që duke respektuar strategjinë, që e ka Komuna për transparencë dhe bashkëpunimin me qytetarë dhe gjithëpërfshirjen e qytetarëve në projektimin e buxhetit do ta keni mundësinë, që këtu bashkë t'i shqyrtojmë çështjet e ndryshme, që janë në interes nga qytetarët.

Fjalën, po e kaloj te Zyrtarja Kryesore Financiare në Komunën e Pejës, znj.Hajrije Haxhijaj, e cila do t'i jep referencat kryesore të projektit të buxhetit dhe pastaj ka hapësirë, që secili nga Ju t'i parashtrojë kërkesat e veta.

Kryetari i Komunës së Pejës, z.Gazmend Muhaxheri i përshëndeti të pranishmit dhe theksoi s'e buxheti i Komunës së Pejës, është i dëmtuar nga nëntori i vitit të kaluar dhe këtë vit gati 11 milionë euro deri tash, pra kjo është rezultat i kontratës kolektive, që e ka bërë Qeveria e Republikës së Kosovës me Sindikatën e Arsimit dhe me Sindikatën e Shëndetësisë. Arsimtarët janë në procedura gjyqësore dhe i kanë marrë diku 6-7 mijë euro varësish deri në 8 mijë, po Komuna pa asnje faj dhe pa asnje marrëveshje për këtë punë është e dënuar për 13 milionë euro dhe të gjitha këto rezultojnë në projekte kapitale dhe në mallra dhe shërbime, sepse parat, të cilat na merren neve kanë me mungu vitin tjetër dhe për këtë arsy për 5-6 milionë euro, që minden me qenë projekte, të cilat barten edhe 1 milion e gjysëm minden me qenë dëme, të cilat na shkaktohen, prej mallrave dhe shërbimeve apo ndonjë projekt të investimit kapital. Ne nuk kemi dashtë të shtyhem i nëpër gjykata me mësimdhënës dhe kemi pranu me ju pagu kontratën kolektive.

Zyrtarja Kryesore Financiare në Komunën e Pejës, znj.Hajrije Haxhijaj i përshëndeti të pranishmit dhe theksoi s'e ndarja e buxhetit bëhet në bazë të Ligjit mbi Menaxhimin e Financave Publike, ku 10 përqind të të hyrave totale të Kosovës ndahen nëpër Komuna dhe pjesa tjetër mbulohet edhe prej të hyrave vetanake, pra buxheti i ndarë për vitin 2025 është 39,689,882, pra është kjo shuma totale e buxhetit, e cila është e ndarë në pesë kategori:

Paga dhe meditje: 18,569,164.75.

Mallra dhe shërbime: 5,297,000.00.

Subvencionet: 1,200,000.00.

Investimet kapitale: 13,618,717.25.

Shpenzimet komunale: 1,005,000.00.

Duhet të theksojmë s'e mund të ketë lëvizje në këto kategori ekonomike për arsyen e neve ende nuk na ka ardhë Qarkorja e Dytë Buxhetore, që ndahet edhe prej Kuvendeve Komunale. Subvencionet janë kategori, të cilat shërbejnë për ndihmën e OJQ-ve, të cilat jepin shërbime sociale, për përkrahjen e fermerëve, për përkrahjen e klubeve sportive, aktivitetave rimore, të cilat organizohen në Komunën e Pejës, ndërsa investimet kapitale janë kategori, që shpenzohen në rregullimin e infrastrukturës rrugore, që përfshinë rrugët, ndërtimin e objekteve shkollore, objekteve shëndetësore, rregullimin e sitemeve të ujitjes nëpër sipërfaqet bujqësore, projekteve të tjera me donatorë të ndryshëm etj. Te kategoria e subvencioneve, prej vitit 2024 kemi një rritje, prej 120 mijë euro, rritja totale e subvencioneve në buxhet është 11.1% aq sa neve na është leju në bazë të Kornizës Afatmesme Buxhetore.

Tani radha është të kemi diskutim nga ana e juaj fillimisht prezantoheni dhe e hapim diskutimin.

**1.Kaltrina Lajçi** – përshëndetje për të gjithë kërkesa e parë e më e rëndësishmja është ndërtimi i një hapësire ose Qendre Rinore për fshatin tonë në Treboviq, tash po i themi edhe shtëpia e fshatit, pastaj edhe vendosjen e disa lodrave për fëmijë, sepse fshati Treboviq është një ndër fshatrat më të mëdha të Komunës së Pejës, kërkesë tjetër është ndriçimi në rrugën "Xhafer Shala", ku trotuari është në përfundim e sipër, pastaj vendosja e policëve të shtrirë në rrugën kryesore, kërkesë tjetër për ndriçim publik në rrugën "Rezistenca e Rugovës", ndriçimi në shkollën "Skënderbeu", sepse janë vendosur vetëm disa poça të thjeshtë elektrik.

**2.Nezir Berbati** – faleminderit, që keni ardhë kërkesën e parë, që e kanë banorët e fshatit të Nabërgjanit, Ruhotit e Trestenik etj., është kanali, i cili vjen prej shkollës ekonomike, sepse jemi para një katastrofe ekologjike, pa e zgjedh këtë problem ky territor është i rrezikuar, ndërsa sa i përket bujqësisë a mund t'i ndihmoni prodhuesit bujqësor me fara, me fara të misrit, sepse subvencionet, po kërkojnë shumë dokumente si me shku në Ambasadë, sepse fshatarët duhet t'i stimuloni, ndërsa sa i përket rrugëve fshati Nabërgjan është mirë, por problem tjetër i kemi mbeturinat, shpresoj të na zgjidhet problemi i ujërave të zeza. Faleminderit shumë!

**3.Arbnor Shabaj** – përshëndetje për të gjithë e kam vetëm një kërkesë për rrugën "Halil Shabi", ndriçim nuk ka, që një kohë të gjatë.

**4.Agim Haxhijaj** - unë së pari do të falënderoj Kryetarin Muhaxheri për bashkëpunimin, që e kemi pas këto dy vitet e fundit, sepse kemi pas investime kapitale, janë rregulluar trotuaret, dua të përmend një rrugë, e cila lidh fshatin Qungur, që kalon nëpër Treboviq, që është investim shumë i mirë edhe me zgjerim edhe me trotuar, punimet ishin duke vazhdu, sa i përket kërkesave për këtë kohë për këtë buxhet, që është paraparë e kemi problem

ndriçimin, si edhe disa rrugë, që janë duke na i shtyrë për shkak të punëkryesit, kemi nevojë për ndriçim te familja "Nikçi" në Treboviq, ndërsa kërkesat e tjera i paraqesim me shkrim.

**5.Shaqir Alija** - nga fshati Zahaq e kam një ankesë për rrugët në fshatin Zahaq, të cilat janë përfundu, që 3-4 vjet, na jemi 6 vëllezërit Alija aty, por asnjëri nuk kemi rrugë të asfaltuar. Ruga kryesore, e cila është aty është me emër "Ulrike Lunacek" normal atë rrugë është dasht me asfaltu më së pari, e keni lënë atë rrugë të pa asfaltuar, ku aty janë edhe 7 familje rome, edhe ata asnjë rrugë s'e kanë, kemi probleme me ujëra të zeza, pastaj i kemi disa shtylla, prej druri dhe duhet të interesoheni, problemin me mbeturina, sepse po ka shumë erë, por mos ta harrojmë edhe problemin me rrugë.

**6.Fisnik Berbati** – përshëndetje për të gjithë segmenti i rrugës "Halil Berbati" janë pesë shtylla të betonit nëse ka mundësi me pas ndriçim, janë disa shtëpi aty. Nuk kam diçka tjetër vetëm, Ju priftë e mbara!

**7.Arben Morina** – përshëndetje për të gjithë i kam disa kërkesa për ndriçim përfshirat Lutogllavë dhe Trestenik, i kemi pas këto kërkesa edhe para një viti, përfshirat ujëra të zeza, në fshatin Lutogllavë, përfshirat disa gypa, sepse është një erë e tmerrshme, pastaj palestrën sportive në fshatin Trestenik, varrezat në fshatin Ruhot, përfshirat rrugë 700 metra, një rrugë tjetër 300 metra, tjetra 400 metra, edhe një rrugë në Lutogllavë te Kelmend diku 400 metra, edhe një trotuar, prej shkollës 800 metra. Të gjitha kërkesat do t'i paraqesim me shkrim në shalltera.

**8.Xhevat Alija** – përshëndetje për të gjithë unë jetoj jashtë, por kam ardhur në emër të vëllaut përfshirat atë rrugën "Ali Ademi", në Nabërgjan nëse keni mundësi të na e ndriçoni? Ju përshëndes të gjithëve!

**9.Xheladin Kuçi** – përshëndetje për të gjithë unë kam qenë edhe në zyrë te Ju, përfshirat dy grazhdie përfshirat ujë, sepse janë shumë të nevojshme, sepse s'kemi pas mundësi këtë vit me ujitet.

**10.Shefqet Ferizi** – përshëndetje për të gjithë kam qenë disahere përfshirat rrugën "Ulrike Lunacek" e s'po na marrin parasysh, s'kemi as ndriçim, as asgjë.

Kryetari i Komunës së Pejës, z.Gazmend Muhaxheri i përshëndeti të gjithë të pranishmit dhe Ju kthej përgjigje të gjithëve me rend përfshirat të gjitha çështjet, të cilat ju interesojnë dhe përfshirat të gjitha kërkesat e tyre.

Kryesuesi takimin e mbylli në ora 21:30.

Procesmbajtësi: Ariana Lukaj

Nr.	EMRI DHE MBIEMRI	VENDBANIMI/ORGANIZATA	GJINIA	NËNSHKRIMI
-----	------------------	-----------------------	--------	------------



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIC OF KOSOVO  
REPUBLIKA KOSOVA



KOMUNA E PEJËS / MUNICIPALITY OF PEJA / OPŠTINA PEĆ

**LISTA E NËNSHKRIMEVE NË TAKIMIN E DEGJIMEVE BUXHETORE PER  
PROJEKT-BUXHETIN VITIN 2025 ME :**

**FSHATRAT TRESENİK, NABERGJAN, TREBOVIQ, RUHOT,  
LUTOGLLAVE, LLABJAN, BLLAGAJE, NAKULL**

Vendi: SHKOLLA FILLORE NABERGJAN

Data: 02.08.2024

Ora: 20:00

Nr.	EMRI DHE MBIEMRI	VENDBANIMI/ORGANIZATA	GJINIA	NËNSHKRIMI
1	Kaltrina Lajgi	Trebovic	F	
2	AGIM HAXHIJAJ	K.L. Treboriq	M	
3	Kushtrim Dresani	NABERGJAN	M	
4	Betim Gashi	RUHOT	M	
5	Ajroci Hadri	TROSTHIK	M	
6	Burimi Muhiqi	TREBOVIA	M	
7	EMRA FERIZI	ZAHAQ		
8	SHEFOËT FERIZI	ZAHAQ		
9	ISMET FERIZI	ZAHAQ		
10	Xhevdet	Nabergjan	M	
11	Rashid Ribiç	Nabergjan		
12	Ethodola Lekë	Nabergjan		
13	Bosnir. Berbati	NABERGJAN	M	
14	Ekrem Berbati	Nabergjan	M	
15	PRSN/ R. Berbati	Nabergjan	M	
16	Lorenat (ota)	Pobedja	F	



Nr.	EMRI DHE MBIEMRI	VENDBANIMI/ORGANIZATA	GJINIA	NËNSHKRIMI
17	Ali Hesloj'	Nabergjani	M	Ali S
18	Sefez Husaj	Nabergjani	M	P
19	DEBNOG SHENSAJ	Nabergjani	M	H
20	SHKELQAN BEZBEP	Nabergjani	M	B
21	Lidion Kdoi	Kutogjale	M	J
22	Sonije Pashimani	ZATAHQ	F	T
23	DITTA ALIJA	ZTA	F	A
24	SHARIK ALIJA	ZTC	M	C
25	KRESOI ALIJA	-	M	E
26	FATIUZ Tashmi	DBF	M	J
27				
28				
29				
30				
31				
32				
33				
34				
35				
36				
37				
38				
39				
40				
41				
42				
43				
44				
45				
46				
47				





REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIC OF KOSOVO  
REPUBLIKA KOSOVA



KOMUNA E PEJËS MUNICIPALITY OF PEJA OPŠTINA PEĆ

---

## DËGJIMET BUXHETORE PËR PROJEKT - BUXHETIN E KOMUNËS SË PEJËS PËR VITIN 2025

**Procesverbal i Dëgjimi buxhetor me OJQ, shoqëri civile, klube sportive dhe organizata, të cilat merren me çështje gjinore.**

Komuna e Pejës - Zyra e Kryetarit

Salla e Kuvendit Komunal në Pejë

Takimi ka filluar në ora: 12:00

Datë: 01.08.2024

Sot, në sallën e Kuvendit Komunal të Pejës, në ora 12:00 është mbajtur dëgjimi publik me OJQ, shoqëri civile, klube sportive, si dhe organizata, të cilat merren me çështje gjinore.

Këto dëgjime publike janë organizuar nga Kryetari i Komunës së Pejës në bashkëpunim me Drejtorinë për Buxhet dhe Financa, si dhe Zyrën për Informim Publik.

Qëllimi i këtyre dëgjimeve është të merren të gjitha kërkesat e qytetarëve nga secili përfaqësues, pastaj t'i nxjerrin prioritetet në bazë të kapaciteteve buxhetore për hartimin e buxhetit të Komunës për vitin 2025.

Në këtë takim kanë qenë të pranishëm Kryetari i Komunës së Pejës, z.Gazmend Muhamxheri, Nënkyetari i Komunës së Pejës, z.Fatmir Asllani, Kryesuesi i Kuvendit Komunal të Pejës, z.Rexhep Kurtbogaj, Drejtoresha për Buxhet dhe Financa në Komunën e Pejës, znj.Diellëza Berisha, Drejtorë të ekzekutivit, të cilët po tregojnë transparencë ndaj qytetarëve dhe kërkesave të tyre.

Takimin e hapi Kryesuesi i Kuvendit Komunal të Pejës, z.Rexhep Kurtbogaj, i cili i përshëndeti të pranishmit dhe Ju uroj mirëseardhje në dëgjimin publik për projektimin e buxhetit për vitin e ardhshëm. Thirrja për këtë takim ka qenë, që duke respektuar strategjinë, që e ka Komuna për transparencë dhe bashkëpunimin me qytetarë dhe gjithëpërfshirjen e qytetarëve në projektimin e buxhetit do ta keni mundësinë, që këtu bashkë t'i shqyrtojmë çështjet e ndryshme, që janë në interes nga shoqëria civile dhe qytetarët.

Fjalën, po e kaloj te Zyrtarja Kryesore Financiare në Komunën e Pejës, znj.Hajrije Haxhijaj, e cila do t'i jep referencat kryesore të projektit të buxhetit dhe pastaj ka hapësirë, që secili nga Ju t'i parashtrojë kërkesat e veta.

Zyrtarja Kryesore Financiare në Komunën e Pejës, znj.Hajrije Haxhijaj i përshëndeti të pranishmit dhe theksoi s'e ndarja e buxhetit bëhet në bazë të Ligjit mbi Menaxhimin e Financave Publike, ku 10 përqind të të hyrave totale të Kosovës ndahen nëpër Komuna dhe pjesa tjeter mbulohet edhe prej të hyrave vetanake, pra buxheti i ndarë për vitin 2025 është 39,689,882, pra është kjo shuma totale e buxhetit, e cila është e ndarë në pesë kategori:

Paga dhe meditje: 18,569,164.75.

Mallra dhe shërbime: 5,297,000.00.

Subvencionet: 1,200,000.00.

Investimet kapitale: 13,618,717.25.

Shpenzimet komunale: 1,005,000.00.

Duhet të theksojmë s'e mund të ketë lëvizje në këto kategori ekonomike për arsyen e neve ende nuk na ka ardhë Qarkorja e Dytë Buxhetore, që ndahet edhe prej Kuvendeve Komunale.

Subvencionet janë kategori, të cilat shërbejnë për ndihmë të OJQ-ve, të cilat japid shërbime sociale, për përkrahjen e fermerëve, për përkrahjen e klubeve sportive, aktiviteteve rinore, të cilat organizohen në Komunën e Pejës, ndërsa investimet kapitale janë kategori, që shpenzohen në rregullimin e infrastrukturës rrugore, që përfshinë rrugët, ndërtimin e objekteve shkolllore, objekteve shëndetësore, rregullimin e sitemeve të ujitjes nëpër sipërfaqet bujqësore, projekteve të tjera me donatorë të ndryshëm etj.

Te kategoria e subvacioneve, prej vitit 2024 kemi një rritje, prej 120 mijë euro, rritja totale e subvacioneve në buxhet është 11.1% aq sa neve na është leju në bazë të Kornizës Afatmesme Buxhetore.

Tani radha është të kemi diskutim nga ana e juaj fillimi si prezantoheni dhe e hapim diskutimin.

**Ardita Ramizi – Bala** nga Qendra pér Mirëqenien e Gruas theksoi s'e Asambleja e ka miratu Strategjinë Kundër Dhunës në Familje, e cila është prej vitit 2024 deri në vitin 2027, po më intereson me ditë a është në këtë buxhet, pra a duhet prapë me apliku a është e buxhetume, sepse aty ka nevojë pér shumë aktivitete, që me punu gjatë këtyre tri viteve, sepse secili prej aktivitetave ka nevojë pér buxhetim.

**Jehona Kelmendi** nga CARE në bashkëpunim me Komunën i falënderojmë pér mbështetjen, që na e kanë dhënë si fermere, gjatë verës, po kemi problem me reshjet e breshërit, që po na i dëmton të mbjellat kërkesa ime është, që me pas një fond, prej Komunës, që na sadokudo me mujt me u bazu dikun, ku mund të kemi një mbështetje, përafërsisht fondi me u menaxhu nga Drejtoria e Bujqësisë, ngajshëm si ai i Ministrisë së Bujqësisë, po me qenë i Komunës. Faleminderit shumë!

**Fitore Cena – Haxhihasani** përfaqësuese e organizatës Qendra pér Jetë të Pavarur në Vitomiricë, që ofron shërbim ditor pér persona me aftësi të kufizuara mendore, njëkohësisht edhe përfaqësuese e organizatave, të cilat janë prezente, siç janë: Pema, Hendikosi, Duart Plot Mëshirë, strehimoren dhe organizatën time faleminderit pér përkrahje dhe pér një bashkëpunim, mirëpo përkrahja nuk është e mjaftueshme pér asnjë organizatë, që ofrojmë shërbime, përderisa Komuna ka nevojë pér këto shërbime ne kemi nevojë pér përkrahje më të madhe sidomos shpenzimet komunale duhet të na paguhen nga komuna pér tërë vitin, jo vetëm aq sa është projekti kemi bisedu edhe me drejtoreshën, që në kërkeshat e ardhshme ta bëjmë kërkeshën të gjitha organizatat, që shpenzimet të na mbulohen gjatë tërë viti, sepse po mbesin obligim i organizatave, që nuk po kemi mundësi me i pagu. Shqetësuese është pér mu pér me i pagu, që mos të vijmë deri te mbyllja e shërbimeve, siç është mbyll pema, prej dhjetorit dhe nuk kemi asnjë informacion dhe të gjitha rastet nga Pema drejtoven tek Hendikosi dhe organizata, që unë e menaxhoj kanë nevojë pér këto shërbime kemi raste, që dy prindërit punojnë dhe fëmijën e kanë me aftësi të kufizuara dhe njëri nga prindërit obligohet me lëshu punën pér shkak të fëmijës, sepse s'ka kujna ja len nën përkujdesje, sepse fëmija nuk është pér shkollë, nuk është pér kopësht dhe është i obliguar me kërkunë ndihmë te organizatat, po thuni, që ka rritje dhe shpresojmë, që kjo rritje të jetë më të vërtetë rritje dhe jo si viti i kaluar, që kemi pas vetëm nga 1000 mijë euro rritje, sepse edhe donatorët, po e theksojnë s'e përkrahjen më të madhe duhet ta kërkoni nga Komuna. Faleminderit pér vëmendjen!

**Arlindë Kastrati** dëshiroj të falënderoi Komunën e Pejës pér mbështetjen, që na është bërë së bashku me CARE Internacional kam disa shqetësime të vogla, si bletare e vogël, që jam aty ku unë veproj me agrobiznesin tim nga hyrja e Bellopojës deri lart vijnë njerëz të papërgjegjshëm, të cilët hudhin mbeturina, po ashtu kemi një banor afër bleiores, ku nuk e di ai object a ka qenë shkollë thojnë përpara ai mbledh gajbica të ndryshme dhe janë bërë fole të minjve edhe prerjen ilegale në atë fushë, sepse të gjitha këto ndikojnë në kullosen e bletës dhe në cilësinë e mjaltit. Faleminderit!

**Sylë Hasani** përshëndetje të nderuar sot në këtë takim marr pjesë në cilësinë e përfaqësuesit të Qendrës së Shëndetit Mendor në Pejë, qendër, e cila merret me problemet mendore të personave të sëmurë dhe jemi anëtarë të mekanizmit koordinues kundër dhunës në familje, ku kanë qenë në vizitë dhe kemi mbajt takime dhe një kërkesë nga ne ka qenë nga mekanizmi, që të na delni në ndihmë të bëjmë një kërkesë për një veturë për Qendër të Shëndetit Mendor edhe pse ne nuk jemi organizatë joqeveritare, por jemi organizatë qeveritare të nivelit sekondar të shëndetësisë, por e mbulojmë terrenin mbi 15 përqind të Komunës duke e përfshirë Pejën, Deçanin, Klinën dhe Istogun për personat me probleme mendore, prandaj në koordinim edhe me anëtaren e mekanizmit kundër dhunës në familje e kemi bërë një kërkesë për ta dorëzuar tek Ju dhe shpreoj, që do të na ndihmoni. Faleminderit!

**Arbëresha Demaj** prej organizatës "Syri i Vizioni" më shumë e kam një kërkesë të përgjithshme në aspektin e projekteve, që organizata implementon dhe siç e dini projektet i kemi me donatorë të huaj, ku shpesh ata kërkojnë në varësi të projekteve na kemi raste kur japim grante për bizneset e vogla ose të mesme ose persona, të cilët janë aktiv në fusha të ndryshme dhe shpesh kemi edhe projekte kur bëhen investime kapitale në varësi të programeve, kemi raste kur donatorët kërkojnë, që një pjesë të jetë në bashkëpunim me komunat dhe ajo çka kërkojmë është edhe pse kemi pas bashkëpunim me Komunën me projektin, që kemi dhënë grante, ku ka ndarë edhe komuna mjete ajo çka po kërkojmë na është që ndonjëherë të kemi reagime pak më të shpejta përgjigjet apo mjetet ku kalohen. Po ashtu, po du me theksu edhe një çështje tjetër të programit, që e kemi në fushën e të gjelbrës ose në fushën e mjedisit, ku prej një takimi, që e kemi pas me qytetarë kanë dal disa çështje ku edhe Kryesuesi ka qenë pjesë e takimit edhe Drejtori i Shërbimeve Publike janë diskutu disa çështje, por dy prej të cilave, po dojmë me i ngrit është pjesa në zonën e Rugovës për shportat e mbeturinave është kérku, që të bëhet diçka për shportat e mbeturinave të jenë në një formë pak më të qëndrueshme ose të jenë statike, që të mos jetë e mundshme, që mbeturinat me u shpërnda dhe të bëhet një plan operativ për deponitë. Faleminderit!

**Blerita Hasani** nga fshatin Sverk falënderoj organizatën CARE në bashkëpunim me Komunën e Pejës për ndihmën, që ma kanë dhanë kërkesat dhe nevojat tonë janë të shumta, por unë kam një kërkesë për deponinë e mbeturinave është bërë shumë edhe qentë endacak na mytjen shumë, po na vijnë së paku 4 deri në 5 qen i kam në oborr, që më rrjinë, si dhe me pas një fond nga komuna për dëmet, të cilat na bëhen prej breshërit, prej erës. Faleminderit!

**Venera Kelmendi** nga fshati Arbanë desha edhe unë një falënderim për Komunën e Pejës dhe organizatën CARE për ndihmën, që na e kanë dhënë. Unë, si bletare kam dy kërkesa në kërkesën e parë i bashkëngjitem koleges për deponinë sepse kemi humbje të mëdha në bletari, sepse po ka shumë insekte, që i kemi edhe tokat pjellore, po na bëjnë dëme, edhe e dyta është kemi mungesë të kanalizmit, ku këto toka janë të punueshme ka fshatarë, që vendosin gropë septike edhe neve po na pamundësohet shfrytëzimi i këtyre ujërave.

**Arita Bojku** – unë kam hapur një biznes timin të vogël dhe po hasi në disa vështirësi dhe po kam nevojë për ndihmë financiare, kam një ëmbëltore të vogël çkado, që më ofrohet, prej Komunës është e mirëseardhur. Faleminderit!

**Fitore Cena – Haxhihasani** theksoi s'e OJQ "Princesha", po merr shumë buxhet, por nuk po e shoh në asnjë takim s'e çka ofron dhe kush është? Singersht është shqetësuese ka marr buxhet edhe në Komunë të Pejës edhe në Ministri buxhetin më të madh në të gjithë Kosovën.

**Idriz Ethemi** nga shoqata "Diabeti" deshta vetëm me i dhënë disa informata s'e vetëm këtë vit numri i personave të prekur nga diabeti është rrit për 34 përqind në qytetin tonë. Një vetëdijesim, një trajnim apo diçka tjeter që ka nevojë personi me diabet kishte me qenë mirë me pas një përkrahje sadopak me mujt me i mbajt s'e obezitetit është shumë i lartë në Komunën tonë, sepse nesër të gjithë mund të jenë të prekur me diabet e të gjitha këto, po ja bëj me dije Drejtoreshës Albulena, e cila thotë s'e shoqata "Diabeti" nuk i takon Qendrës Sociale dhe besoj, që Komuna e Pejës sadopak do të na përkrah në projektet tona të mëtutjeshme duke e falënderuar edhe "Syrin e Vizionit" me AQH dhe shumë organizata të tjera internacionale. Kryetarin e falënderoi për përkrahjen për insulina për ata fëmijë, që disa vite na ka përkrah për blerjen e tyre.

**Ardita Kastrati** nga fshati Dobërdol së pari ju falënderoj për mbështetjen e fermerëve edhe në fshatin Dobërdol ka ndryshu jeta se infrastruktura shumë e mirë, por neve na mungon kanalizimi i ujërave të zeza, ku unë aty punoj dhe veproj me biznesin tim me bletari edhe ujësjellësi në fshat na mungon. Faleminderit!

Kryetari i Komunës së Pejës, z.Gazmend Muhamheri i përshëndeti të gjithë të pranishmit dhe Ju kthej përgjigje të gjithëve me rend për të gjitha çështjet, të cilat ju interesojnë dhe për të gjitha kérkesat e tyre.

Kryesuesi takimin e mbylli në ora 14:00.

Procesmbajtësi:


Ariana Lukaj



Nr.	EMRI DHE MBIEMRI	VENDBANIMI/ORGANIZATA	GJINIA	NËNSHKRIMI
-----	------------------	-----------------------	--------	------------



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIC OF KOSOVO  
REPUBLIKA KOSOVA



KOMUNA E PEJËS / MUNICIPALITY OF PEJA / OPŠTINA PEĆ

**LISTA E NËNSHKRIMEVE NË TAKIMIN E DEGJIMEVE BUXHETORE PER  
PROJEKT-BUXHETIN VITIN 2025 ME :**

**SHOQERIN CIVILE, OJQ, GRUPE TJERA TE INTERESIT**

Vendi:Salla e Kuvendit






Data:01.08.2024

Ora:12:00

Nr.	EMRI DHE MBIEMRI	VENDBANIMI/ORGANIZATA	GJINIA	NËNSHKRIMI
1	Vlera Kumova	QPS - PEJË	F	Vlumova
2	Pasiqare Bërdin	JARIN - PEJË	F	P. Bërdini
3	Anastasija Boša	QMG - SKE	F	A. Boša
4	Xhaçtina Kastrioti	Dobroboj - Pejkë	F	X. Kastrioti
5	Mojiga Kelmen	OJQ, D.P.M. Pejë	F	M. Kelmen
6	Arditë këshiqet.	Dobroboj - kery	F	A. kery
7	Fitore Haxhësani	OJQ, Q. J. P. Vitomericë	F	F. Haxhësani
8	Arita Bošku	MBRETRESHATEVTE - PEJË	F	Bosku
9	Florice Gjonaj	OSBE PESE	F	F. Gjonaj
10	Emrusti Osman	Pr. Nënsht Tebare Sh. GO / GIPSAT - FWT	M	E. Osman
11	Mojiga Yrob	DBPH - Pejë	F	M. Yrob
12	Rita Berisha	CARE International	F	R. Berisha
13	Arta Demi	CARE	F	A. Demi
14	Thelgjikë Berisha	CARE	F	T. Berisha
15	Melouci Kryq. Kekuadi	CARE	F	M. Kekuadi
16	SHPRESA LUKA	D.M. S	F	S. Luka
17	Gjergjim Turku	DBF	M	G. Turku



Nr.	EMRI DHE MBIEMRI	VENDBANIMI/ORGANIZATA	GJINIA	NËNSHKRIMI
-----	------------------	-----------------------	--------	------------

18	DONJEJA BERIJNAD	DBF	F	
19	FATMIR INANI	DBF	M	
20	EZGJOW QERKASIU	HANDICOS	M	
21	IDRIZ GTHEMI	SHQ. DIABETIT	M	
22	Kullmet Gushini	DKRS	M	
23	SYLË HASANI	QEUDRA E SHËNDETIT MELODZ - PEPË	M	
24	FARUK OPGI	QYTETARI	M	
25	ALINDA MUHAMERI KOSTADI	SHQ. BLELATAT E PESË	F	
26	BLERTA HASANI	SFERK	F	
27	PRAVER REXHAJ	JABLLANC VO GEL	F	
28	VENER KOLMENDI	ARBAN	F	
29	SANJA JAHUROVIĆ	QEUDRI	F	
30	AGIM MALA	D. ADMINISTRATËS	M	
31	GËZIM SPASINI	QEUDRA PËR	M	
32	FAHDE MALA	PESË - QEUDRA	M	
33	JASNUZ HAZOREJ	PESË FSHATATORI	M	
34	AUHI GASHI	Fidanashke - PEPË	M	
35	DURIM KLEMENDI	PEPË	M	
36	XHENET SPALI	DKRS	M	
37				
38				
39				
40				
41				
42				
43				
44				
45				
46				
47				
48				





REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIC OF KOSOVO  
REPUBLIKA KOSOVA



KOMUNA E PEJËS MUNICIPALITY OF PEJA OPŠTINA PEĆ

---

**DËGJIMET BUXHETOKE PËR PROJEKT - BUXHETIN E KOMUNËS SË PEJËS PËR VITIN 2025**

**Procesverbalı – Dëgjimi buxhetor me banorët e fshatrave të Podgurit.**

Komuna e Pejës - Zyra e Kryetarit

Shkolla fillore në Novosellë

Takimi ka filluar në ora: 19:30

Datë: 05.08.2024

Në, shkollën fillore, në Novosellë, në ora 19:30 është mbajtur dëgjimi publik me banorët e fshatrave të Podgurit.

Këto dëgjime publike janë organizuar nga Kryetari i Komunës së Pejës në bashkëpunim me Drejtorinë për Buxhet dhe Financa, si dhe Zyrën për Informim Publik.

Qëllimi i këtyre dëgjimeve është të merren të gjitha kërkesat e qytetarëve nga secili përfaqësues, pastaj t'i nxjerrin prioritetet në bazë të kapaciteteve buxhetore për hartimin e buxhetit të Komunës për vitin 2025.

Në këtë takim kanë qenë të pranishëm Nënkyetari i Komunës së Pejës, z.Fatmir Asllani, Kryesuesi i Kuvendit Komunal të Pejës, z.Rexhep Kurtbogaj, Nënkyetari për Komunitete në Komunën e Pejës, z.Mirzet Džogović, Drejtoresha për Buxhet dhe Financa, znj.Diellëza Berisha, Drejtori për Bujqësi, z.Tahir Shala dhe Drejtori për Çështje Pronësoro - Juridike, z.Arianit Krasniqi, të cilët po tregojnë transparencë ndaj qytetarëve dhe kërkesave të tyre.

Takimin e hapi Kryesuesi i Kuvendit Komunal të Pejës, z.Rexhep Kurtbogaj, i cili i përshëndeti të pranishmit dhe Ju uroj mirëseardhje në dëgjimin publik për projektimin e

buxhetit për vitin e ardhshëm. Thirrja për këtë takim ka qenë, që duke respektuar strategjinë, që e ka Komuna për transparencë dhe bashkëpunimin me qytetarët dhe gjithëpërfshirjen e qytetarëve në projektimin e buxhetit do ta keni mundësinë, që këtu bashkë t'i shqyrtojmë çështjet e ndryshme, që janë në interes nga qytetarët.

Fjalën, po e kaloj te kryesuesi i Grupit Punues, z.Egzon Kastrati, i cili do t'ju prezantoj referencat kryesore të buxhetit.

Kryesuesi i Grupit Punues, z.Egzon Kastrati i përshëndeti të pranishmit dhe theksoi s'e buxheti i ndarë për vitin 2025 është 39,689,882, pra është kjo shuma totale e buxhetit, e cila është e ndarë në pesë kategori:

Paga dhe meditje: 18,569,164.75.

Mallra dhe shërbime: 5,297,000.00.

Subvencionet: 1,200,000.00.

Investimet kapitale: 13,618,717.25.

Shpenzimet komunale: 1,005,000.00.

Duhet të theksojmë s'e mund të ketë lëvizje në këto kategori ekonomike për arsyen e neve ende nuk na ka ardhë Qarkorja e Dytë Buxhetore, që ndahet edhe prej Kuvendeve Komunale. Subvencionet janë kategori, të cilat shërbejnë për ndihmë të OJQ-ve, të cilat japid shërbime sociale, për përkrahjen e fermerëve, për përkrahjen e klubeve sportive, aktivitetave rimore, të cilat organizohen në Komunën e Pejës, ndërsa investimet kapitale janë kategori, që shpenzohen në rregullimin e infrastrukturës rrugore, që përfshinë rrugët, ndërtimin e objekteve shkollore, objekteve shëndetësore, rregullimin e sitemeve të ujitjes nëpër sipërfaqet bujqësore, projekteve të tjera me donatorë të ndryshëm etj.

Te kategoria e subvacioneve, prej viti 2024 kemi një rritje, prej 120 mijë euro, rritja totale e subvacioneve në buxhet është 11.1% aq sa neve na është leju në bazë të Kornizës Afatmesme Buxhetore.

Tani radha është të kemi diskutim nga ana e juaj fillimisht prezantoheni dhe e hapim diskutimin.

**1. Blerta Rexhaj** – përshëndetje për të gjithë unë jam Kryetare e Këshillit Lokal në Radavc, po i paraqes kërkosat, të cilat më janë dukur mua dhe Këshillit Lokal më të rendësishme është ambulanata në fshatin Radavc, projekti ekziston, kanalet e ujitjes, rregullimin e qendrës në Novosellë, trotuari dhe ndriçimi në Vardishte, një rrugë shumë e rrezikshme, sepse ka pas edhe humbje jete.

**2.Sylë Peli** – përshëndetje për të gjithë unë jam nga Novosella dhe si fshatës më i madhi për nga numri i banorëve. Ne i kemi disa kërkesa të arsyeshme eshtë punu bukur shumë, por prapë duhet të punohet, na ka mbet një lagje, e cila ka nevojë për ndriçim, eshtë shtrati i lumit Shushicë, na nevojitet edhe një mur deri te kodrat, te bregu aty për shkak s'e e kemi një sipërfaqe të pashfrytëzuar, me e përgatit për parking, pastaj i kemi disa rrugica ende të papërfunduara, prej ambulantës deri te familja Mahmutaj atje, mirëmbajtja në përgjithësi kemi nevojë për një punëtor në fshatin tonë, si dhe kanalet e ujitjes.

**3.Imer Mujaj** - përshëndetje për të gjithë unë jam nga Jabllanica e Vogël i kemi disa rrugica, për t'i asfaltuar më e gjata eshtë 35 metra, e kemi një rrugë më rëndësi, prej qendres së fshatit te shtëpia e kulturës, e cila lidhet me rrugën kryesore për Istog, qendra e fshatit nuk eshtë e rregulluar, një pjesë të përronit, pastaj eshtë një shesh edhe ata e kemi parapa me e rregullu, pastaj janë rrugët kryesore, janë katër rrugë, kanalet e ujitjes, pesë kanale të ujitjes, që janë më kryesoret, pastaj e kemi një mur. Të gjitha kërkesat do t'i paraqesë me shkrim. Faleminderit!

**4.Naim Tahiri** - përshëndetje për të gjithë unë jam nga Novosella dëgjova për buxhetin, i cili eshtë ndarë për vitin e ardhshëm dhe e di, që ka shumë kërkesa, unë kisha pas dëshirë edhe nga Ju një sqarim lidhur me disa rrugica, të cilat janë të hapura në fshatin tonë, janë përgatitur, për asfalt, mirëpo nuk janë asfaltu, janë diku 8 rrugica? Problem tjetër eshtë ndriçimi i fshatit edhe pse ekziston në shumicën e fshatit, por eshtë jofunksional, sepse shumica e drizave nuk punojnë, pastaj neve na intereson edhe projekti i kanalizimit, s'e janë shumë gypa, ne e kemi shtëpinë e lagjes dhe nëse ka mundësi të bëhet renovimi i saj. Ju faleminderit shumë për vëmendjen.

**5. Edison Bërdyna** - përshëndetje për të gjithë unë jam nga Novosella çështjen, të cilën e kemi prioritet eshtë kanalizimi, janë fut disa gypa, por janë shumë të vegjël dhe nuk janë funksional, problem tjetër eshtë shtrati i lumit e di, që kanë dal disa gjeodet për ta shikuar, pastaj problem tjetër e kemi rrugën për bjeshkë.

**6.Nehat Bajraktari** - përshëndetje për të gjithë unë jam nga Radavci kam dëshirë të punohet toka, pra eshtë fjala për kanalet e ujitjes, s'e ka kërkesa të vazhdueshme dhe kemi nevojë prej Komunës për vitin e ardhshëm me i parapa 2 hektarë, diku 25 mijë euro i takojnë Komunës e të tjerat i bëjmë vetë, eshtë një sektor në të cilin ja vlen Komuna me investu, po ashtu deshta me shfrytëzu rastin edhe me falënderu publikisht Drejtorin e Bujqësisë në Komunën e Pejës, z.Tahir Shala për ndihmën dhe përkrahjen, që na e ka dhënë.

**7.Alban Rexhaj** - përshëndetje për të gjithë unë jam nga Jabllanica e Vogël shumica nuk kemi qenë të njoftuar për takimin e ditës së sotme, nuk e di kush është dasht me i informu banorët, fshatrat e Pejës kanë kërkesa shumë, prandaj nuk po di a duhet me fol a mos me fol hiç, Imeri i përmendi disa rrugica, të cilat janë të papërfunduara, na e kemi prioritet rrugën e bjeshkës, unë e kam një projekt, që ka mbet në letër, i kemi mbledh nënshkrimet e fshatarëve, që mos me kundërshtu askush dhe e kemi dërgu kërkesën në Komunën e Pejës, atëherë kur ka qenë Drejtoreshë për Shërbime Publike, znj.Xhevahire Çeku edhe e kanë bërë njëfarë paramase inxhinierët e Komunës, çka është bërë na më s'kemi ditë asgjë? Sa i përket bujqësisë te ne nuk është investuar hiç, janë përfundu diku rrëth 600 metra kanale të ujites, prandaj ne kemi të drejtë kërkesat tona me i paraqit para juve, janë disa investime të vogla, të cilat janë bërë, pra prioritet për të gjithë ne është rruga e bjeshkës.

**8.Dren Brahimaj** - përshëndetje për të gjithë unë jam nga Novosella e kam një kërkesë në emër të lagjes "Haxhiaj" është një rrugë, e cila nuk është e shtruar në asfalt për atë rrugë e kam dorëzu vetë kërkesën kur ka qenë Drejtoreshë për Shërbime Publike në Komunën e Pejës, znj.Xhevahire Çeku dhe janë marr nënshkrimet e të gjithë banorëve me vetëfinancim është hap ajo rrugë në këtë fillim të vitit, e cila është 400 metra dhe lidhet me një kullë historike, e cila ka qenë shtabi i UÇK-ës në vitet e 90-ta, ku kanë prit e përcjell mijëra ushtarë, pastaj janë disa varreza, të cilat i takojnë periudhës osmane dhe janë duke u shkatërruar, të cilat i përkasin komunitetit shqiptarë. Faleminderit shumë për vëmendjen!

**9.Arsim Ibraj** - përshëndetje për të gjithë unë jam nga Jabllanica e Madhe dhe investimet e nevojshme për fshatin Jabllanicë e Madhe janë:

1. Uji për pije.
2. Asfaltimi i rrugëve që kanë mbetur pa asfaltim.
3. Rregullimi i përroit dhe një pende në rrugën "Zenun Zeqiri" deri në derdhje në lum.
4. Përfundimi i murit te Hasanajt, në rrugën "Dëshmorët e Jabllanicës".
5. Vazhdimi i kanalizimit të fshatit.
6. Rrëthimi i varrezave.
7. Fusha e volejbollit dhe e basketbollit në oborrin e shtëpisë së kulturës.
8. Përforcimi i murit mbrojtës ose futja në beton e prronit përgjatë gjithë rrugës "Dëshmorët e Jabllanicës (nga dyert e Binak Tafilajt deri te shtëpia e Islam Zekajt).
9. Vadë për ujitje nga xhamia deri te shtëpia e Binak Tafilajt.
- 10.Ndërtimi i trotuarit për fshatin përgjatë rrugës "Dëshmorët e Jabllanicës".
- 11.Rregullimi i rrugëve për në fusha bujqësore (kodrat, rruga e veshtijeve deri në fusha, rruga te livadhet e Dem Alajve dhe rruga te kroni i Doçit).
12. Ndërtimi i përrockave te Avni Ibraj.
13. Një pend te shtëpia e Haki Ademit.

Këto janë disa nga investimet e nevojshme të identifikuara për përmirësimin e infrastrukturës dhe mirëqenies në fshatin Jabllanicë e Madhe.

**10. Donjeta Bërdynaj –** përshëndetje për të gjithë unë e kam një kërkesë për një rrugë te Bërdynajt rreth 300 metra dhe një kanal të ujitjes.

Nënkryetari i Komunës së Pejës, z.Fatmir Asllani i përshëndeti të gjithë të pranishmit dhe Ju kthej përgjigje të gjithëve me rend për të gjitha çështjet, të cilat ju interesojnë dhe për të gjitha kërkesat e tyre.

Kryesuesi takimin e mbylli në ora 21:10.

Procesmbajtësi:


Ariana Lukaj



Nr.	EMRI DHE MBIEMRI	VENDBANIMI/ORGANIZATA	GJINIA	NËNSHKRIMI
-----	------------------	-----------------------	--------	------------



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPÙBLIC OF KOSOVO  
REPUBLIKA KOSOVA



KOMUNA E PEJËS / MUNICIPALITY OF PEJA / OPŠTINA PEĆ

**LISTA E NËNSHKRIMEVE NË TAKIMIN E DEGJIMEVE BUXHETORE PER  
PROJEKT-BUXHETIN VITIN 2025 ME :**

**FSHATRAT E PODGURIT**

Vendi: SHKOLLA FILLORE NE NOVOSELLE

Data: 05.08.2024

Ora: 19:30

Nr.	EMRI DHE MBIEMRI	VENDBANIMI/ORGANIZATA	GJINIA	NËNSHKRIMI
1	AVNI PELAJ	NOVOSELLE	M.	
2	BESIM PELAJ	NOVOSELLE	M.	
3	MUHAMMED PELI	NOVOSELLE	M	
4	FAZUL RODRUGA	NOVOSELLE	M	
5	GAZMONG TURKU	PERZ/DBF	P	
6	Fatmir Jusufi	Perz/DBF	M	
7	EDISON BERDINA	NOVOSELLE	M	
8	Naimi Salihi	Novoselle	M	
9	Ramo Mahmutoviç	Novoselle	M	
10	ARSIM IBROJ	KABILMIC F. MADHE	W	
11	ERION BARAKARTA	PERDAVC	M	
12	BESTORT Mušaj	ZAD. VOGL	M	
13	ARTAN ADEYAJ	J. BELLASIC & VOGL	M	
14	BESIMIZ ADEYAJ	J. VOGL	M	
15	BESIM ADEYAJ	J. VOGL	M	
16	BESNIKADEYAJ	J. VOGL	M	



Nr.	EMRI DHE MBIEMRI	VENDBANIMI/ORGANIZATA	GJINIA	NËNSHKRIMI
17	VALMIR REKHAJ	JABLLANCHE E UZBEK	M	<i>Rehaj</i>
18	FATLINO REKHAJ	JASLANICE E UZBEK	M	<i>Rehaj</i>
19	Jucor Muja	J. E. VOGEL	01	<i>Jucor</i>
20	XHEVAT SAHITHA	Novoselle	M.	<i>X. S. H.</i>
21	Daush Elsayaf	Inzumie avocet	M	<i>D. Elsayaf</i>
22	ISUF ADEMJA	- II -	M.	<i>Ademja</i>
23	Nesat BAFRAKTAZI	RADAC	M	<i>Bafraktazi</i>
24	STYLE PELI	Novoselli	M	<i>Style Peli</i>
25	Dren Brakimo	Novoselle	M	<i>D. Brakimo</i>
26	Nicmo, B. Brakimo	Newgelle	M	<i>Nicmo, B. Brakimo</i>
27	Berta Rexha	Jabllancë e vogël	F	<i>B. Rexha</i>
28	Ergon Kafet	KK page	M	<i>Ergon Kafet</i>
29				
30				
31				
32				
33				
34				
35				
36				
37				
38				
39				
40				
41				
42				
43				
44				
45				
46				
47				





REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIC OF KOSOVO  
REPUBLIKA KOSOVA



KOMUNA E PEJËS MUNICIPALITY OF PEJA OPŠTINA PEĆ

---

**DËGJIMET BUXHETORE PËR PROJEKT - BUXHETIN E KOMUNËS SË PEJËS PËR VITIN 2025**

**Procesverbali – Dëgjimi buxhetor me banorët e qytetit, me të gjitha Bashkësitë Lokale.**

Komuna e Pejës - Zyra e Kryetarit

Salla e Kuvendit Komunal në Pejë

Takimi ka filluar në ora: 18:30

Datë: 01.08.2024

Sot, në sallën e Kuvendit Komunal të Pejës, në ora 18:30 është mbajtur dëgjimi publik me banorët e qytetit, me të gjitha Bashkësitë Lokale.

Këto dëgjime publike janë organizuar nga Kryetari i Komunës së Pejës në bashkëpunim me Drejtorinë për Buxhet dhe Financa, si dhe Zyrën për Informim Publik.

Qëllimi i këtyre dëgjimeve është të merren të gjitha kërkesat e qytetarëve nga secili përfaqësues, pastaj t'i nxjerrin prioritetet në bazë të kapaciteteve buxhetore për hartimin e buxhetit të Komunës për vitin 2025.

Në këtë takim kanë qenë të pranishëm Kryetari i Komunës së Pejës, z.Gazmend Muhaxheri, Kryesuesi i Kuvendit Komunal të Pejës, z.Rexhep Kurtbogaj, Drejtoresha për Buxhet dhe Financa në Komunën e Pejës, znj.Diellëza Berisha, Drejtorë të ekzekutivit, të cilët po tregojnë transparencë ndaj qytetarëve dhe kërkesave të tyre.

Takimin e hapi Kryesuesi i Kuvendit Komunal të Pejës, z.Rexhep Kurtbogaj, i cili i përshëndeti të pranishmit dhe Ju uroj mirëseardhje në dëgjinin publik për projektimin e buxhetit për vitin e ardhshëm. Thirrja për këtë takim ka qenë, që duke respektuar

strategjinë, që e ka Komuna për transparencë dhe bashkëpunimin me qytetarë dhe gjithëpërfshirjen e qytetarëve në projektimin e buxhetit do ta keni mundësinë, që këtu bashkë t'i shqyrtojmë çështjet e ndryshme, që janë në interes nga qytetarët.

Fjalën, po e kaloj te Zyrtarja Kryesore Financiare në Komunën e Pejës, znj.Hajrije Haxhijaj, e cila do t'i jep referencat kryesore të projektit të buxhetit dhe pastaj ka hapësirë, që secili nga Ju t'i parashtrojë kërkesat e veta.

Zyrtarja Kryesore Financiare në Komunën e Pejës, znj.Hajrije Haxhijaj i përshëndeti të pranishmit dhe theksoi s'e ndarja e buxhetit bëhet në bazë të Ligjit mbi Menaxhimin e Financave Publike, ku 10 përqind të të hyrave totale të Kosovës ndahen nëpër Komuna dhe pjesa tjetër mbulohet edhe prej të hyrave vetanake, pra buxheti i ndarë për vitin 2025 është 39,689,882, pra është kjo shuma totale e buxhetit, e cila është e ndarë në pesë kategori:  
Paga dhe meditje: 18,569,164.75.  
Mallra dhe shërbime: 5,297,000.00.  
Subvencionet: 1,200,000.00.  
Investimet kapitale: 13,618,717.25.  
Shpenzimet komunale: 1,005,000.00.

Duhet të theksojmë s'e mund të ketë lëvizje në këto kategori ekonomike për arsy s'e neve ende nuk na ka ardhë Qarkorja e Dytë Buxhetore, që ndahet edhe prej Kuvendeve Komunale.

Subvencionet janë kategori, të cilat shërbejnë për ndihmë të OJQ-ve, të cilat japid shërbime sociale, për përkrahjen e fermerëve, për përkrahjen e klubeve sportive, aktiviteteve rinore, të cilat organizohen në Komunën e Pejës, ndërsa investimet kapitale janë kategori, që shpenzohen në rregullimin e infrastrukturës rrugore, që përfshinë rrugët, ndërtimin e objekteve shkollore, objekteve shëndetësore, rregullimin e sitemeve të ujites nëpër sipërfaqet bujqësore, projekteve të tjera me donatorë të ndryshëm etj.

Te kategoria e subvacioneve, prej vitit 2024 kemi një rritje, prej 120 mijë euro, rritja totale e subvacioneve në buxhet është 11.1% aq sa neve na është leju në bazë të Kornizës Afatmesme Buxhetore.

Tani radha është të kemi diskutim nga ana e juaj fillimisht prezantoheni dhe e hapim diskutimin.

**Xhevati Kajolli** nga rruga "Gazmend Zajmi", i cili theksoi s'e edhe vjet kam qenë për rrugën tanë e kam bërë kërkesën sepse jemi keq me infrastrukturë, kërkesa e parë është s'e gypat e ujtit janë shumë të vjetër, pastaj kemi probleme me katër shtylla elektrike, ato janë të vendosura para çdo dugoje, ndërsa te unë është më së keqi, sepse është e kapur për shtëpi, te kojshia i fundit, që e ka shtyllën 3 here kanë intervenu zjarrfikësat, ndërsa kërkesa e tretë

është, që pllakat janë të vendosura para 40 vjetëve dhe janë shumë të vjetëruara dhe sipas zyrtarëve të komunës, po thojnë s'e diçka mirë dojnë me bo aty me kubëza, si te hotel "Dukagjini".

**Kadri Mavraj** nga Bashkësia Lokale "7 Shtatori" i përshëndeti të pranishmit në përgjithësi dhe Ju uroj suksese të mira për me fillu me kërkesa kujtoj s'e janë të njohura për Komunën, janë të dorëzuara diku në fillim të vitit, nëse ka nevojë me i përsërit, po i përsëriti nga viti 2020 kur erërat e fortë kanë dëpërtuar në pjesën tonë, shtyllat, të cilat janë dëmtuar në atë kohë ende nuk janë riparuar kam shku në KEDS me kérkesë, që me ardhë deri te rregullimi i tyre dhe më thanë, që kjo është punë e komunës, ndërsa i thashë, që e imja është me marr informacion për adresimin e kérkesave çdo shtyllë, që ka dëmtim është obligim i komunës, pra mbetet në kompetencat e juaja, që shtyllat dhe ndriçimi me të vërtetë në lagjen "7 Shtatori" për me i pas parasysh për rregullim nga viti 2021 jemi të qartë me kérkesat dhe punët, të cilat kanë përfundu në lagjen "7 Shtatori" i kemi disa rrugë, ku janë kryer kanalizimet e ujërave të zeza, është bërë përgatitja për asfalt, por arsyet janë tregu edhe herën e kalume, që tenderët ata, të cilët i kanë pas janë tërhek dhe rrugët kanë mbet ashtu, që përmes rrjeteve sociale, po pranojmë akuza çka është ba gjithka punët, po kryhen e veç te na s'po kryhen, pra kérkesat do t'i adresojmë edhe njëherë me shkrim për me i përsërit. Jemi dëshmitarë të të reshurave atmosferike, janë bërë të rrezikshme e ka ndërru kahjen uji, prandaj duhet me dal me stafin e Drejtorisë së Shërbimeve Publike te fabrika e tjegullave me i shiku mundësitetë për ujërat, sikur te market "Lukaj", që e kemi në këtë pjesën e poshtme, jemi shumë të rrezikuar tash e tutje, prej asaj pjese, ndërsa në "Fidanishte" është i njoftuar Kryetari Muhamheri, por edhe të tjerët i kemi disa lisa shumë të mëdhenj, ku me pa zgjatë shumë ajo furtuna e madhe pasojat do të ishin shumë të mëdha, sepse lisat kanë marrë përbysje, prandaj duhet me pas konsideratë, sepse po më vjen shumë keq me ja gjujt barren Kryetarit të Komunës për dëmet, të cilat mund të vijnë në të ardhmen. Rruga "Naum Veqilharxhi", rruga "Zhuj Veseli" janë përfundu thuja 2 herë brenda një viti, njëherë është gjerryer, pastaj asfaltimi, ndërsa banorët e pjesës së lartë e kanë një ankesë shumë të madhe, sepse infrastruktura është goxha e ligë, me kanalizimet e ujërave të zeza i kemi 2-3 rrugë, që kanë nevojë urgjente, ndërsa te emërtimi i rrugëve, si duket janë lënë pak pasdore komisioni mos t'i harrojnë. Do t'i adresojmë problemet në shalltera.

**Pal Marku** jam përfaqësues i kishës katolike në Pejë do të ndalem në tri pika, ku kërkesa e parë është një prioritet kryesor, që është në kuadër të parcelës së varrezave të komunitetit katolik të na e ndërttoni një objekt, në të cilin besimtarët tanë do ta kishin mundësinë ta kryenin ceremoninë e varrimit, prej prites së ngushëllimeve deri në kryerjen e riteve fetare, përfshirë edhe një frigorifer për qëndrimin e arkivolit deri të kryhet ceremonia e varrimit, kërkesa tjetër është të na e ndriçoni oborrin e kishës katolike "Shën Katerina", ndërsa kërkesa e tretë është për rregullimin e rrugës, besoj që është 1 km, te kisha katolike në Rugovë në Kuçishtë, sepse rruga është prishur krejt. Këto janë kérkesat tona. Faleminderit!

**Nexhat Miroci** nga Bashkësia Lokale "Xhemaj Kada" në Pejë deshta për një rrugë, e cila është shumë e dëmtuar është fjala për rrugën "Shtjefën Gjeçovi", e cila fillon prej bankës "Pro Credit" e deri përafërsisht 350 metra. Kryetar atë ditë ka qenë Drejtori Nikçi me bashkëpunëtorë dhe e kanë konstatuar s'e rruga duhet të asfaltohet edhe deshta një informacion te ajo rruga "Mikel Marku" dhe te rruga "Via Egnatia" ajo te shkolla a keni informacion pse është ndal, pse nuk po vazhdohet aty? Faleminderit!

**Bejhan Krasniqi** nga Bashkësia Lokale "Karagaqi" në Pejë e kam një kërkesë, prej banorëve të lagjes "Edith Durham", që 45 vjet me pas mundësi me renovu e me vendos kanalizimin e ri s'e kena probleme të mëdha kur të bjen shi. Faleminderit!

**Valbona Avdijaj** nga Bashkësia Lokale "2 Korriku" në Pejë theksoi s'e në "2 Korrik", po punohet shumë mire, janë duke vazhduar punimet d.m.th. asfaltimi kur të përfundohet kanali ka me vazhdu, por unë kisha dasht dy rrugë, që janë 30 metra rrugë, pra rruga "Gjergj Fishta", në anën e djathtë me asfaltu kur t'i vjen radha me këto të tjerat bashkë dhe rruga "Dëshmorët e Peklenës", aty janë 40 metra dhe në krye të "Asllan Çeshmes" janë 150 metra, por për ndriçim në këtë rrugë shtyllat janë 10 shtylla, kam bërë kërkesë disahere, por trupat ndriçues nuk janë vendos, ndërsa në rrugën "Kapiten Rudi" edhe aty shtyllat janë, por ndriçim nuk ka hiç. Kryetar në emër të banorëve, faleminderit shumë!

**Haki Lajqi** nga Bashkësia Lokale "Kristal" në Pejë përshëndetje për të gjithë në emër të banorëve i kam disa kërkesa, sepse janë tri vite në "Kristal" nuk është punu asgjë kanalizmi është shumë keq, 58 shtëpi kanalizim nuk kanë, pastaj është rruga te shkolla "Smajl Hajdari", aty asnjë zebër nuk është edhe për policë të shtrirë në rrugën "Fatos Ademaj" i kemi pas dy raste të vdekjes, ndërsa kërkesat për asfalt, rruga "Vlora" janë 220 metra, rruga "Fadil Nimani" janë pesë rrugë 550 metra, "Vëllezërit Kastrati", "Gani Daci" 180 metra, "Haxhi Tahiri" 170 metra, rruga "Shaban Bajraktari" janë dy rrugë 300 metra, pra këto kërkesa janë më primare.

**Agim Nikqi** nga Bashkësia Lokale "Rrokaqjelli" në Pejë përshëndetje te unë ku jetojmë më së shumti keni punu, por unë prapë kam kërkesa, prej Mullirit të Haxhi Zekës, kanali Seravi, pastrimi dhe rregullimi i tij, kanali po bën dëme kur ka reshje të shiut, rregullimin e rrugës nga rruga kryesore "Papa Klemente", pas shkollës së mesme teknike, janë bërë disa ndërtesa dhe rruga është prishur goxha shumë, deri 400 metra, rregullimi dhe vendosja e shtyllave elektrike, rruga "Mikel Marku" te shkolla e të verbërëve, ka prokuroria, me i vendos të reja, rregullimi i trotuarit dhe vendosja e shtyllave elektrike te rruga "Vëllezërit Gërvalla", te stacioni i autobusëve, vendosjen e kanalizimit të ri në rrugën "Vëllezërit Kryeziu", janë diku 300 metra, si dhe një palestër të sporteve, po ashtu edhe pagesat e vërvimeve, si dhe pagesat e neve Kryetarëve të Bashkësive Lokale.

**Luan Pavata** nga Bashkësia Lokale "Sahat Kulla" përshëndetje për të gjithë të pranishmit për "Sahat Kullë" i kemi goxha do s'e na janë mbledhur disa punë, rruga deri te restaurant "Era"

edhe kanalizimi edhe ndriçimi, është dëmtuar shumë, pastaj rruga pas spitalit janë ato rrethojat, që janë dëmtu shumë duhet të hapet ajo rrugë, policë të shtrirë janë duke kërkuar shumë nga spitali, po i rrezikojnë nxënësit, probleme me disa shtylla ndriçuese, të cilat janë vetëm për mirëmbajtje, shaktat te Nazmi Gega, si po bjen një shi, po mbulohet, ndërsa famullia e paraqiten vetë kërkesën, kanalizimi a ka lëviz diçka edhe i kemi tri rrugica, edhe problemin e lopëve, që e kemi.

**Gazmend Turk** nga "Sahat Kulla" te Bashkësia Lokale "Sahat Kulla" ne e kemi një problem, që tensioni i lartë kalon në mes të shtëpive dhe oborreve kish qenë mirë me vesh, sepse takohet me pemët dhe është rrezik për banorët, te rruga "Gjergj Fishta" nuk ka policë të shtrirë dhe do të ishte mirë t'i vendosni.

Kryetari i Komunës së Pejës, z.Gazmend Muhaxheri i përshëndeti të gjithë të pranishmit dhe Ju kthej përgjigje të gjithëve me rend për të gjitha çështjet, të cilat ju interesojnë dhe për të gjitha kërkesat e tyre.

Kryesuesi takimin e mbylli në ora 20:00.

Procesmbajtësi:

Ariana Lukaj



Nr.	EMRI DHE MBIEMRI	VENDBANIMI/ORGANIZATA	GJINIA	NËNSHKRIMI
-----	------------------	-----------------------	--------	------------



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIC OF KOSOVO  
REPUBLIKA KOSOVA



KOMUNA E PEJËS / MUNICIPALITY OF PEJA / OPŠTINA PEĆ

***LISTA E NËNSHKRIMEVE NË TAKIMIN E DEGJIMEVE BUXHETOKE PER  
PROJEKT-BUXHETIN VITIN 2025 ME :***

***Bahkësit Lokale të Qytetit***

Vendi:Salla e Kuvendit

Data:01.08.2024

Ora:18:30

Nr.	EMRI DHE MBIEMRI	VENDBANIMI/ORGANIZATA	GJINIA	NËNSHKRIMI
1	HAKKI LLAJOI	KAPSTAL	M	Kufiqi
2	Nexhat Miroci	B.T. "XH. KADA"	M	Shqipetar
3	BEJHARI KRASNIQI	B.Z - KARICAJ	M	Shqipetar
4	VALBONA AVADAJ	B.L. 2 KORRIKU	F	Armen
5	XHEVAT KAZOLI	RZ GAZMEN ZAJMI	M	Xhevat
6	GRIGORIO PRICER	SACAT KUCIA 1 FEB 26	M	Grigorio
7	Jonuz Herzeraj	Peje	N	Jonuz
8	Fluter Joseph	OSCE PEJE	F	Fluter
9	FOTOFA BULQIZAJ	FEDE, OSIDEA	M	Bulqiza
10	PAL MARRCI	PEJE RASHA-KATOLIK	M	Simeon
11	ALOIM NIKOJI	KL. RLOKACIELL	M	Aloim
12	LUCAN PAVATA	SACAT KUCIA	M	Lucan
13	KADRI MAURAJ	B.L. "SHITATORI"	M	Maurrey
14	FATMIR INANI	DBE	M	Fatmir
15	FISNIK IMANI	PUNOVE - SOTHA KUCIA	M	Fisnik
16	afolter gergor	Kapeteshnicë	M	Gergor
17	Menat Spas Holmed	QENDRA 1	Q	Menat



Nr.	EMRI DHE MBIEMRI	VENDBANIMI/ORGANIZATA	GJINIA	NËNSHKRIMI
-----	------------------	-----------------------	--------	------------

49	GAZMEND MUHAMMEDI	KP TETAR	M	G. L.
50	HAKJING HAXH JAH	RASHTA	F	H. JAH.
51	Dilekca Bozbuja	Pejë	F	Dilekca Bozbuja
52				
53				
54				
55				
56				
57				
58				
59				
60				
61				
62				
63				
64				
65				
66				
67				
68				
69				
70				
71				
72				
73				
74				
75				
76				
77				
78				
79				





REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIC OF KOSOVO  
REPUBLIKA KOSOVA



KOMUNA E PEJËS MUNICIPALITY OF PEJA OPŠTINA PEĆ

---

**DËGJIMET BUXHETORE PËR PROJEKT - BUXHETIN E KOMUNËS SË PEJËS PËR VITIN 2025**

**Procesverbali – Dëgjimi buxhetor me banorët e fshatrave të Rugovës.**

Komuna e Pejës - Zyra e Kryetarit

Salla e Kuvendit Komunal në Pejë

Takimi ka filluar në ora: 18:30

Datë: 02.08.2024

Sot, në sallën e Kuvendit Komunal të Pejës, në ora 18:30 është mbajtur dëgjimi publik me banorët e fshatrave të Rugovës.

Këto dëgjime publike janë organizuar nga Kryetari i Komunës së Pejës në bashkëpunim me Drejtorinë për Buxhet dhe Financa, si dhe Zyrën për Informim Publik.

Qëllimi i këtyre dëgjimeve është të merren të gjitha kërkesat e qytetarëve nga secili përfaqësues, pastaj t'i nxjerrin prioritetet në bazë të kapaciteteve buxhetore për hartimin e buxhetit të Komunës për vitin 2025.

Në këtë takim kanë qenë të pranishëm Kryetari i Komunës së Pejës, z.Gazmend Muhaxheri, Kryesuesi i Kuvendit Komunal të Pejës, z.Rexhep Kurtbogaj, Drejtoresha për Buxhet dhe Financa në Komunën e Pejës, znj.Diellëza Berisha, Drejtorë të ekzekutivit, të cilët po tregojnë transparencë ndaj qytetarëve dhe kërkesave të tyre.

Takimin e hapi Kryesuesi i Kuvendit Komunal të Pejës, z.Rexhep Kurtbogaj, i cili i përshëndeti të pranishmit dhe Ju uroj mirëseardhje në dëgjin publik për projektimin e buxhetit për vitin e ardhshëm.

Thirrja për këtë takim ka qenë, që duke respektuar strategjinë, që e ka Komuna për transparencë dhe bashkëpunimin me qytetarë dhe gjithëpërfshirjen e qytetarëve në projektimin e buxhetit do ta keni mundësinë, që këtu bashkë t'i shqyrtojmë çështjet e ndryshme, që janë në interes nga qytetarët.

Fjalën, po e kaloj te Zyrtarja Kryesore Financiare në Komunën e Pejës, znj.Hajrije Haxhijaj, e cila do t'i jep referencat kryesore të projektit të buxhetit dhe pastaj ka hapësirë, që secili nga Ju t'i parashtrojë kërkesat e veta.

Kryetari i Komunës së Pejës, z.Gazmend Muhaxheri i përshëndeti të pranishmit dhe theksoi s'e buxheti i Komunës së Pejës, është i dëmtuar nga nëntori i vitit të kaluar dhe këtë vit gati 11 milionë euro deri tash, pra kjo është rezultat i kontratës kolektive, që e ka bërë Qeveria e Republikës së Kosovës me Sindikatën e Arsimit dhe me Sindikatën e Shëndetësisë. Arsimitarët janë në procedura gjyqësore dhe i kanë marrë diku 6-7 mijë euro varësisht deri në 8 mijë, po Komuna pa asnë faj dhe paasnë marrëveshje për këtë punë është e dënuar për 13 milionë euro dhe të gjitha këto rezultojnë në projekte kapitale dhe në mallra dhe shërbime, sepse parat, të cilat na merren neve kanë me mungu vitin tjetër dhe për këtë arsy për 5-6 milionë euro, që munden me qenë projekte, të cilat barten edhe 1 milion e gjysëm munden me qenë dëme, të cilat na shkaktohen, prej mallrave dhe shërbimeve apo ndonjë projekt të investimit kapital. Ne nuk kemi dashtë të shtyhem i nëpër gjykata me mësimdhënës dhe kemi pranu me ju pagu kontratën kolektive.

Zyrtarja Kryesore Financiare në Komunën e Pejës, znj.Hajrije Haxhijaj i përshëndeti të pranishmit dhe theksoi s'e ndarja e buxhetit bëhet në bazë të Ligjit mbi Menaxhimin e Financave Publike, ku 10 përqind të të hyrave totale të Kosovës ndahen nëpër Komuna dhe pjesa tjetër mbulohet edhe prej të hyrave vetanake, pra buxheti i ndarë për vitin 2025 është 39,689,882, pra është kjo shuma totale e buxhetit, e cila është e ndarë në pesë kategori:  
Paga dhe meditje: 18,569,164.75.  
Mallra dhe shërbime: 5,297,000.00.  
Subvencionet: 1,200,000.00.  
Investimet kapitale: 13,618,717.25.  
Shpenzimet komunale: 1,005,000.00.

Duhet të theksojmë s'e mund të ketë lëvizje në këto kategorë ekonomike për arsy s'e neve ende nuk na ka ardhë Qarkorja e Dytë Buxhetore, që ndahet edhe prej Kuvendeve Komunale. Subvencionet janë kategori, të cilat shërbejnë për ndihmë të OJQ-ve, të cilat

japin shërbime sociale, për përkrahjen e fermerëve, për përkrahjen e klubeve sportive, aktiviteteve rimore, të cilat organizohen në Komunën e Pejës, ndërsa investimet kapitale janë kategori, që shpenzohen në rregullimin e infrastrukturës rrugore, që përfshinë rrugët, ndërtimin e objekteve shkolllore, objekteve shëndetësore, rregullimin e sitemeve të ujites nëpër sipërfaqet bujqësore, projekteve të tjera me donatorë të ndryshëm etj. Te kategoria e subvencioneve, prej vitit 2024 kemi një rritje, prej 120 mijë euro, rritja totale e subvencioneve në buxhet është 11.1% aq sa neve na është leju në bazë të Kornizës Afatmesme Buxhetore.

Tani radha është të kemi diskutim nga ana e juaj fillimi si prezantoheni dhe e hapim diskutimin.

**1.Sali Lajqi** - përfaqësues i fshatit Malaj, po ju përshëndes të gjithëve dhe nevoja për investime ka kudo, që të sillesh rezervari për ujë në fshatin Malaj, ne jemi ra dakord me fshatin Pepaj për një rrugë, që me na lidh të dy fshatrave, pastaj edhe rrugën për Prevar – Gjollaj edhe Sllanopoj do të ishte një rrugë, që do t'i jepte impakt të madh turizmit në Rugovë, është pjesë e pa eksploruar, ne e kemi bërë një plan-projekt para tri viteve, rruga në total i ka 9 km e 600 metra, rregullimi i rrugës për fshatin Malaj, sepse po ka lëvizje të gurëve. Ne në fshatin Malaj e kemi një muze është muzeu "Ibrahim Rugova", pranë memorialit "Ibrahim Rugova", në muze ka shumë gjëra të vjetra të rugovasve, të cilat i ruajmë. Unë kam folur disahere me Drejtreshën e muzeut në Pejë, që muzeu i Rugovës me kalu në kuadër të muzeut në Pejë, për të hyrë në buxhet komunal, sepse çdo ditë i ka mbi dhjetë vizitorë dhe secili prej tyre nënshkruhet dhe i shënon përshtypjet e veta, por dua të theksoi s'e ai muze nuk i përket vetëm Malajve, por i përket Komunës së Pejës dhe të gjithë neve, prandaj do të duhej, që të gjithë ne të kujdesimi për atë muze, sepse duhet të krenohemi me traditën dhe kulturën tonë. Do të flasë pak edhe për tensionin e ulët, sepse kam bërë disahere kërkesa në KEDS, ndërsa tash është duke u shtri rrjeti i ri për Rugovë, me pas një mundësi Komuna sadopak në bashkëfinancim me ne komunitetin një trafo me e bart në Komunë. Unë personalisht e lëshoj tokën time për trafo, tensionin e lartë e kam pesë metra, prej vendit ku mundem me liru vendin për trafo, sepse do të na ndihmonte shumë në kthimin e banorëve.

**2.Fitim Dreshaj** - përshëndetje për të gjithë, sot kam ardhë si përfaqësues i fshatit Kuçishtë, kërkesa jonë është asfaltimi i rrugës, prej Tranumes deri te lagija jonë i ka diku rreth 2 km, jemi 20-30 shtëpi, është dëmtu shumë. Faleminderit!

**3.Demë Salihaj** - përfaqësues i fshatit Kuçishtë ju përshëndes të gjithëve na i kemi disa kërkesa të fshatit, është rruga prej rrugës kryesore ka kisha deri në lagje asfaltimi i saj, pastaj është rruga e Bardhajve, që ka mbet është ndal komplekt, pastaj për lagjen time, prej mahalles deri te ura me u lidh me asfalt, gati 80 përqind është e përfunduar, pastaj e kemi edhe një bazen për lagjen Leqinat s'e kanë problem me ujë, Lici ka mbet pa qasje s'e s'mundesh me dal, prandaj me pas ndonjë mundësi me u hap edhe ajo rrugë, për

elektrifikim janë t'u punu, e kam edhe një kërkesë për lagjen "Fidanishte", në Pejë jam me shtëpi aty edhe vetë Kryetari Muhaxheri dhe Drejtori Nikçi e kanë pa s'e neve na ka fshi uji tash po pritet, që ka me pas prapë vërvshime, pra na keni premtu, që keni me bo diçka s'e na keni lanë keq.

**4.Ramiz Qorraj** - përshëndetje për të gjithë fshati Drelaj sa i përket kërkesave të fshatit Drelaj na i kemi adresu edhe me shkrim, pranë Komunës, në Drejtorenë për Punë Komunale dhe Zyrës së Kryetarit, do t'i përsërisë prapë, sa i përket rrugës për Leqinat, e cila ka fillu para 3-4 viteve, shpresojmë, që do të fillojnë punët, sepse vonesat, po bëjnë dëme në rrugë e duhet të intervenohet në disa mure mbrojtëse, një projekt të ujësjellësit për pjesën e Leqinatit dhe shpresojmë, që këtë vit të bëhet diçka sepse ka shumë shtëpi, janë burimet edhe projekti është i gatshëm, problem e kemi edhe ujin e pijshëm, një projekt tjeter i rrugës, që të dërgon te Leqinati i Drelajve edhe i Kuçishtes është prioritet.

**5.Driton Mujaj** - përshëndetje për të gjithë jam nga fshati Dugaivë e kam një kërkesë të vetme, që e kam parashtru, që disahere e kemi një rrugë në fund të fshatit, jemi diku mbi 40 familje, që kemi mbet pa asfalt, janë dy rrugë 1,5 km kanë gjatësi.

**6.Isuf Iajqi** - përshëndetje për të gjithë fshati Shtupeq i Vogël i kemi dy kërkesa me rëndësi, që janë rruga për të hyrë në fshat është pengesë, që disa vjet, është e pakalueshme, ne e kemi punu një projekt për ujë, ndërsa për rrugë projektin e punuar e kemi moti, që e kemi dorëzu në Komunë.

**7.Agim Haxhijaj** - përshëndetje për të gjithë për punën, që është bërë në trevën e Rugovës, së pari dua ta falënderoj Kryetarin Muhaxheri s'e është bërë punë e madhe, ndërsa investimi kapital është duke u bërë për rrymë, pasi jam nga fshati Bogë i Rugovës në fshatin tonë e ke bërë një punë të mire, sepse projekt i juaj, që vetë e keni ideuar, e që është duke u punuar është kanali i shirave, prej 600 metrave dhe shpresoj, që do të vazhdojë edhe pjesa e dytë, prej 500 metra, e di, që ke pengesa në realizimin e projekteve, po qysh ke probleme në realizimin e ujësjellësit, ku rrëth 3 km kalon në tokat tona, që është ndërprerë, e po të ishte vazhduar ai projekt fshatrat Bogë – Shkrel – Dugaivë sot do të ishin të furnizuara me ujë, por fatkeqësisht ne si banorë nuk po jemi të përgjegjshëm, prandaj kërkojmë e në fund i ndalojmë punimet. Unë në këtë rast kam vetëm një kërkesë në fshatin Bogë janë bizneset e vetme, të cilat nuk kanë lidhje me rrugë, me asfalt, pasi është në përfundim kanali i shirava do të doja, që në buxhetin e vitit të ardhshëm të jetë e paraparë një rrugë, prej 1500 metra dhe të lidhte këto biznese me asfalt. Respekt për punën tuaj.

**8.Fitim Dreshaj** - krahas kërkesës për asfaltimin dhe zgjerimin e rrugës e kemi edhe një kërkesë tjetër ndërtimin e një rezervari të ujit, prandaj shpejtë e dërgojmë në formë të shkruar.

**9.Shaban Lajçi** - përshëndetje unë jam Kryetar i fshatit Pepaj dhe e kam një kërkesë rrithimi i varrezave në fshatin Pepaj, si dhe asfaltimi i rrugës Pepaj – Masajle.

**10.Nezir Iberdemaj** – përshëndetje për të gjithë unë jam Kryetar i fshatit Shtupeq i Vogël është hera e parë, që marr pjesë në debat për diskutim të buxhetit në fshatin tonë dihet sa është investu edhe kërkesat i kemi, që moti, pra kemi kërkesë për rrugë, për ujësjellës, ka shumë kërkesa, por këto i kemi prioritare. Në fshatin tonë do të ishte mirë, që të orientoheni vitin e ardhshëm, ne projektin për ujësjellës e kemi, për rrugë e kemi dërgu moti, nëse nuk na bëhet rruga, siç na ka thanë Kryetari te këto kthesat poshtë asfalt le të na bëhen, qato 5 ose 6 km, që janë më lartë e poshtë besoj e bëjmë një zgjidhje. E kemi një problem te rruga e Peklenes, ajo është bërë, që sa kohë për me bë hapjen e atij gurit, që të jetë rruga e kalueshme. Ne rrugë nuk kemi hiç, sepse nëse e kemi një rrugë turizmi do të zhvillohej edhe tek ne si në fshatrat e tjera të Rugovës. Ujin dhe rrymën i kemi prioritet. Projektin e ujit javën tjetër e dorëzoj.

**11.Rabe Nikçi** – Unë i kam disa kërkesa Reka e Allagës si fshat i madh, rruga, e cila ka nis të asfaltohet, por e kam një kërkesë për rrugën , e cila e lidh Rekën e Allagës me Shtupeqin e Madh e kam bërë disahere kërkesën, prej Qafës së Broqit ka qenë rrugë ekzistuese, por është prishur, kërkesa tjetër është për një ujësjellës, ne kemi banorë shumë dhe kemi nevojë për ujë, po ashtu edhe për elektrifikim, vetëm pjesa jonë s'ka elektrifikim, pra nëse këto kërkesa mund të na i realizoni.

Kryetari i Komunës së Pejës, z.Gazmend Muhaxheri i përshëndeti të gjithë të pranishmit dhe Ju kthej përgjigje të gjithëve me rend për të gjitha çështjet, të cilat ju interesojnë dhe për të gjitha kërkesat e tyre.

Kryesuesi takimin e mbylli në ora 19:40.

Procesmbajtësi:

Ariana Lukaj



Nr.	EMRI DHE MBIEMRI	VENDBANIMI/ORGANIZATA	GJINIA	NËNSHKRIMI
-----	------------------	-----------------------	--------	------------



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIC OF KOSOVO  
REPUBLIKA KOSOVA



KOMUNA E PEJËS / MUNICIPALITY OF PEJA / OPŠTINA PEĆ

**LISTA E NËNSHKRIMEVE NË TAKIMIN E DEGJIMEVE BUXHETORE PER  
PROJEKT-BUXHETIN VITIN 2025 ME :**

**FSHATRAT E RUGOVES**



Vendi:Salla e Kuvendit

Data:02.08.2024

Ora:18:30

Nr.	EMRI DHE MBIEMRI	VENDBANIMI/ORGANIZATA	GJINIA	NËNSHKRIMI
1	ALEM REQIBI	SH. VOGËL	M	
2	Isuf Lajzi	SH. VOGËL	M	
3	Rabia Niko	R. A. Uagac	F	
4	Dzemë Salihaj	Kyqishfoj	M	
5	Sali Mustafa	Pëgj	M	
6	Eduiz Ronkoj	Lulzim	M	
7	SHABAN LAJQAI	PEPAJ	M	
8	Gazi J. Fazai	Milit	M	
9	ERIONE MUSAJ	DUKA IVE	M.	
10	Fikri Gjonaj	OSCE NRC PE	F	
11	ZENTITH SHAFETI	PE 76	M	
12	FITIM DRESHAJ	KUQISHTË	M	
13	BRAHIM LAJQAI	SH. VOGËL	M	
14	MILOT BARDHI	KUQISHTË	M	
15	Anni GASHI	K.K. Pjetë	M	
16	Kastriot Belegu	Komuna e Pejes	M	
17	FATNIR Ramani	DBF	M	



Nr.	EMRI DHE MBIEMRI	VENDBANIMI/ORGANIZATA	GJINIA	NËNSHKRIMI
17	AGRON NIKOVIĆ	VITONERICË	M	
18	FATMIRE ASLLANI	PESË	M	
19	GAZMEND MUHAMMEDI	-II-	M	
20	HAJRITA HAXHIJAJ	-I-	F	
21	Ergon Kastrati	-II-	M	
22	LEXHER KURT BOGAI	Kryemdi komunal	M	
23	efriana Luka	ZIP	F	
24	MEZRIK BORDANI	SHTUCERQ, Vogë/ M	M	
25	AGIM HAXHIJAJ	BOQE	M	
26				
27				
28				
29				
30				
31				
32				
33				
34				
35				
36				
37				
38				
39				
40				
41				
42				
43				
44				
45				
46				
47				





REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIC OF KOSOVO  
REPUBLIKA KOSOVA



KOMUNA E PEJËS MUNICIPALITY OF PEJA OPŠTINA PEĆ

---

**DËGJIMET BUXHETORE PËR PROJEKT - BUXHETIN E KOMUNËS SË PEJËS PËR VITIN 2025**

**Procesverbali – Dëgjimi buxhetor me banorët e fshatrave Vitomiricë, Katundi i Ri, Brestovik, Lipë, Dubovë dhe Ozdrim.**

Komuna e Pejës - Zyra e Kryetarit

Qendra Rinore në Vitomiricë

Takimi ka filluar në ora: 18:00

Datë: 05.08.2024

Në, Vitomiricë, në ora 18:30 është mbajtur dëgjimi publik me banorët e fshatrave Vitomiricë, Katundi i Ri, Brestovik, Lipë, Dubovë dhe Ozdrim.

Këto dëgjime publike janë organizuar nga Kryetari i Komunës së Pejës në bashkëpunim me Drejtorinë për Buxhet dhe Financa, si dhe Zyrën për Informim Publik.

Qëllimi i këtyre dëgjimeve është të merren të gjitha kërkesat e qytetarëve nga secili përfaqësues, pastaj t'i nxjerrin prioritetet në bazë të kapaciteteve buxhetore për hartimin e buxhetit të Komunës për vitin 2025.

Në këtë takim kanë qenë të pranishëm Nënkyetari i Komunës së Pejës, z.Fatmir Asllani, Kryesuesi i Kuvendit Komunal të Pejës, z.Rexhep Kurtbogaj, Nënkyetari për Komunitete në Komunën e Pejes, z.Mirzet Džogović, Drejtoresha për Buxhet dhe Financa, znj.Diellëza Berisha, Drejtori për Bujqësi, z.Tahir Shala, Drejtori për Shërbime Publike, z.Agron Nikçi dhe Drejtori për Çështje Pronësoro - Juridike, z.Arianit Krasniqi, të cilët po tregojnë transparencë ndaj qytetarëve dhe kërkesave të tyre.

Takimin e hapi Kryesuesi i Kuvendit Komunal të Pejës, z.Rexhep Kurtbogaj, i cili i përshëndeti të pranishmit dhe Ju uroj mirëseardhje në dëgjimin publik për projektimin e buxhetit për vitin e ardhshëm. Thirrja për këtë takim ka qenë, që duke respektuar strategjinë, që e ka Komuna për transparencë dhe bashkëpunimin me qytetarë dhe gjithëpërfshirjen e qytetarëve në projektimin e buxhetit do ta keni mundësinë, që këtu bashkë t'i shqyrtojmë çështjet e ndryshme, që janë në interes nga qytetarët.

Fjalën, po e kaloj te kryesuesi i Grupit Punues, z.Egzon Kastrati, i cili do t'ju prezantoj referencat kryesore të buxhetit.

Kryesuesi i Grupit Punues, z.Egzon Kastrati i përshëndeti të pranishmit dhe theksoi s'e buxheti i ndarë për vitin 2025 është 39,689,882, pra është kjo shuma totale e buxhetit, e cila është e ndarë në pesë kategori:

Paga dhe meditje: 18,569,164.75.  
Mallra dhe shërbime: 5,297,000.00.  
Subvencionet: 1,200,000.00.  
Investimet kapitale: 13,618,717.25.  
Shpenzimet komunale: 1,005,000.00.

Duhet të theksojmë s'e mund të ketë lëvizje në këto kategori ekonomike për arsyen e neve ende nuk na ka ardhë Qarkorja e Dytë Buxhetore, që ndahet edhe prej Kuvendeve Komunale. Subvencionet janë kategori, të cilat shërbejnë për ndihmë të OJQ-ve, të cilat japid shërbime sociale, për përkrahjen e fermerëve, për përkrahjen e klubeve sportive, aktiviteteve rimore, të cilat organizohen në Komunën e Pejës, ndërsa investimet kapitale janë kategori, që shpenzohen në rregullimin e infrastrukturës rrugore, që përfshinë rrugët, ndërtimin e objekteve shkollore, objekteve shëndetësore, rregullimin e sitemeve të ujitjes nëpër sipërfaqet bujqësore, projekteve të tjera me donatorë të ndryshëm etj. Te kategoria e subvencioneve, prej vitit 2024 kemi një rritje, prej 120 mijë euro, rritja totale e subvencioneve në buxhet është 11.1% aq sa neve na është leju në bazë të Kornizës Afatmesme Buxhetore.

Tani radha është të kemi diskutim nga ana e juaj fillimisht prezantoheni dhe e hapim diskutimin.

**1.Xhevdet Ahmetaj** – përshëndetje për të gjithë unë jam nga Lipa, pra ne i kemi kërkesat e njëjtë, rruga Brestovik – Lipë e Vogël, asfaltimi dhe zgjerimi i rrugës, në lagjen "Salihaj", rrjeti

i ujësjellësit, zgjerimi dhe asfaltimi i rrugës Brestovik – Dushkajë është shumë e nevojshme, po ashtu edhe rrjeti i ndriçimit është i nevojshëm.

**2.Qerim Krasniqi** - Ne në Vitomiricë i kemi disa punë, që kanë përfundu, por i kemi edhe disa, që janë të papërfunduara, me rrymë kemi shumë problem, nuk është punu as në ngitjen e kapacitetit të trafeve, Vitomirica është goxha e madhe me tri rajone, sa i përket ujtit të pijes është punu në rrjet, por kemi nevojë edhe për një intervenim, sa i përket asfaltimit janë asfaltu respekt për të gjithë, sivjet i kemi shti disa rrugë në projekt, nuk na kanë mbet shumë dhe besoj s'e do të kryhen edhe ato, trotuari duke nisur nga rrethi e deri poshtë na jemi pa ndriçim, për mbeturina, po kemi probleme, sepse ne i bëjmë rregullisht pagesat, sa i përket bujqësisë këtu te na nuk jemi të kënaqur dhe sipas kërkesave të qytetarëve, kanë kérku sera apo diçka dhe shumë pak janë ndarë te na, por kemi nevojë për përmirësim, shpresojmë që kërkesat do të na plotësohen, po ashtu edhe një kërkesë te ekonomia atje poshtë për një rrugë e ka me shtru me këtë projektin, që është për biznese, shtalla, fabrika ose diçka tjeter, pronari quhet Arianit Krasniqi.

**3.Fatmir Dubovci** – Vijë nga Mitrovica, ndërsa janë dhjetë vite, që jam në Vitomiricë, nëse ka mundësi me u shtru dhe me u zgjeru rruga në asfalt, sepse e kam ndërtu shtëpinë aty, që tetë vite dhe e kam me leje, rruga është “Avda Medović”, rruga e parë majtas.

**4.Pleurat Berisha** – Unë jam përfaqësues i tokave edhe shtallave këtu në Vitomiricë, besoj, që janë shumë të nevojshme kanalet e ujitjes, në atë zone, gypat nuk janë, nuk ju shkon ujët, bujqësia është primare për ne.

**5.Faik Balic** – Jam nga Vitomirica dhe kërkesa ime është, që të bëni disa investime në objektin e Domit të Kulturës në Vitomiricë.

**6.Shkumbin Prekaj** – Unë i përfaqësoj fshatrat Dubovë dhe Ozdrim ne kemi nevojë për disa rrethoja të shkollës mundësish, pastaj rrethojat e varrezave për dy fshatrat, trotuari në Ozdrim, edhe 400 metra asfalt për vitin e ardhshëm dhe përfundon gjithçka. Faleminderit!

**7.Rifat Lajqi** – Jam përfaqësues i fshatit Dushkajë i kemi 3 km e 100 metra për asfalt, që disa vite, po bëhet, sot, po bëhet nesër, por nuk e di, kisha pas qejf vitin e ardhshëm me kanë e asfaltuar.

**8.Rexhep Hasani** – Jam nga fshati Lipë e kam paraqitur një kërkesë për një përmendore te kroni në Lipë atje, është fjala për 3000 mijë euro.

Nënkyetari i Komunës së Pejës, z.Fatmir Asllani i përshëndeti të gjithë të pranishmit dhe Ju kthej përgjigje të gjithëve me rend për të gjitha çështjet, të cilat ju interesojnë dhe për të gjitha kërkesat e tyre.

Kryesuesi takimin e mbylli në ora 19:15.

Procesmbajtësi:

Ariana Lukaj

Nr.	EMRI DHE MBIEMRI	VENDBANIMI/ORGANIZATA	GJINIA	NËNSHKRIMI
-----	------------------	-----------------------	--------	------------



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIC OF KOSOVO  
REPUBLIKA KOSOVA



KOMUNA E PEJËS / MUNICIPALITY OF PEJA / OPŠTINA PEĆ

**LISTA E NËNSHKRIMEVE NË TAKIMIN E DEGJIMEVE BUXHETORE PER  
PROJEKT-BUXHETIN VITIN 2025 ME :**

**VITOMERICE, KATUND I RI BRESTOVIK, LIPE, DUBOVE, OZDRIM**



Vendi: QENDRA RINORE VITOMERICE

Data: 05.08.2024

Ora: 18:00

Nr.	EMRI DHE MBIEMRI	VENDBANIMI/ORGANIZATA	GJINIA	NËNSHKRIMI
1	Ymerjet Ahmetaj	LiPë	M	Alimi
2	Rexhep HASAN	Li Pë	M	Hasan
3	RIFAT LAZRI	DUSHTAZ	M	Lazri
4	FATI BULIC	VITOMERICE	M	Bulic
5	Burhom Feqiri	Vitomericë	M	Feqiri
6	Qerion Kosnogi	Vitomericë	M	Kosnogi
7	Omer Honsic	Pejë	M	Honsic
8	VETON SHALA	VITOMERICË	M	Shala
9	Futmir Dubovci	Vitomericë	M	Dubovci
10	Malem Polushaj	LiPë	M	Polushaj
11	Hoxhi Ahmeti	LiPë	M	Ahmeti
12	DAYT LASAJI	DUSHTAZ	M	Lasaji
13	Pecajet Berisha	Vitomericë	M	Berisha
14	Sali Zekaj	VITOMERIC	M	Zekaj
15	Shkukim Prekaj	K.L. DUBOVE - OZDRIM	M	Prekaj
16	SAMI GASHI	FSH OZDRIM	M	Gashi



Nr.	EMRI DHE MBIEMRI	VENDBANIMI/ORGANIZATA	GJINIA	NËNSHKRIMI
17	Alprim Shala	Vitomericë	M	
18	Ariani Krasniqi	KK POSO	F	
19	Izet Velić	Vitomericë	M	
20	Murat Dzogani	Vitomericë	M	
21	LEXHEP KURANGAI	K.K. PEJE	M	
22	Tarek Asseeri	K POSO	M	
23	TAHIR SHAH	K POSO	M	
24	Dileesa Berisha	K Peje	F	
25	Fatima Tumani	DBF	M	
26	Adem JIKSI	VITOMERICË	M	
27	Gjergj TURIA	P616 DBF	R	
28				
29				
30				
31				
32				
33				
34				
35				
36				
37				
38				
39				
40				
41				
42				
43				
44				
45				
46				
47				

